



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.83

8 korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.415, datë 2.6.2010	Për miratimin e Raportit të Parë Kombëtar Periodik, në kuadër të protokollit opsional të konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë	4309
Vendim i KM nr.422, datë 26.5.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Llëngë”, dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë..	4332
Vendim i KM nr.428, datë 9.6.2010	Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes	4333
Vendim i BSH nr.37, datë 16.6.2010	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Credins sh.a.....	4343
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Hasan Poda.....	4344
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Artur Saliu	4344
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Halit Ferhati.....	4344

VENDIM
Nr.415, datë 2.6.2010

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PARË KOMBËTAR PERIODIK, NË KUADËR TË
PROTOKOLLIT OPSIONAL TË KONVENTËS SË OKB-SË “PËR TË DREJTAT E
FËMIJËVE”, PËR SHITJEN E FËMIJËVE, PROSTITUCIONIN DHE PORNOGRAFINË
ME FËMIJË**

Në mbështetje të neneve 100 e 122 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.9834, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të parë kombëtar periodik, në kuadër të protokollit opsional të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**RAPORTI I PARË KOMBËTAR PERIODIK NË KUADËR TË PROTOKOLLIT OPSIONAL TË
KONVENTËS SË OKB-SË “PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE”, PËR SHITJEN E FËMIJËVE,
PROSTITUCIONIN DHE PORNOGRAFINË ME FËMIJË**

I. Hyrje

1. Me ligjin nr.9834, datë 22.11.2007, Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar protokollin opsional të konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë.

Duke e vlerësuar procesin e raportimeve, me urdhër të Kryeministrit nr.201, datë 5.12.2007 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e raporteve kombëtare në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë” është ngarkuar Ministria e Punëve të Jashtme me detyrën e hartimit të raporteve kombëtare periodike në bashkëpunim me institucionet shtetërore. Teksti i përgatitur është konsultuar edhe me shoqërinë civile që merret me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ky grup pune ka për detyrë hartimin e raporteve kombëtare për konventat në të cilat vendi ynë është palë, të pasqyrojë situatën aktuale, progresin e arritur, si dhe problemet në fushat përkatëse. Ky grup pune përbëhet nga përfaqësues të të gjitha ministrive dhe të institucioneve qendrore, si dhe nga përfaqësues të shoqërisë civile, aktive në fushën e të drejtave të fëmijës.

2. Ky protokoll dhe konventa për të drejtat e fëmijëve, pas ratifikimit në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Ato përbëjnë bazën për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa, gjithashtu për një reformë të përgjithshme të politikave sociale për të krijuar një mjedis mbrojtës për fëmijët, që nënkupton mjedisin familjar, institucionet, sistemet dhe shoqërinë që rrethojnë fëmijën.

3. Për këtë çështje mund t'i referohemi raportit të fundit mbi konventën për të drejtat e njeriut të Shqipërisë.

4. Në Kushtetutën Shqiptare (neni 122) thuhet se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Kjo dispozitë e Kushtetutës

është e një rëndësie të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sepse edhe në rastet kur në legjislacionin e brendshëm ka mangësi mund të zbatohen direkt dispozitat e Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës dhe të këtij protokollit.

5. Nuk ka rezerva.

6. Në raport gjenden të dhënat e siguruara nga autoritetet kompetente, që dëshmojnë se, shitja, prostitucioni dhe pornografia e fëmijëve, megjithëse nuk janë vepra të përhapura, po vihen seriozisht në epiqendër të vëmendjes së autoriteteve kompetente për parandalimin dhe zgjidhjen e tyre.

II. Statistika

9. Të dhënat për veprat penale të përfshira në protokoll janë mbledhur nga organet kompetente, konkretisht, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë.

10. Statistika të viteve të fundit për këto krime:

Në vitin 2005 për veprën penale të “Trafikimit të fëmijëve” janë evidentuar 10 raste, me 16 autorë, 4 të arrestuar, 11 në gjendje të lirë, 1 në kërkim.

Në vitin 2006 për veprën penale të “Trafikimit të fëmijëve” janë evidentuar 2 raste, me 4 autorë, 3 të arrestuar, 1 në gjendje të lirë, 1 në kërkim.

Në vitin 2007 për veprën penale të “Trafikimit të fëmijëve” janë evidentuar 7 raste, me 7 autorë, 5 të arrestuar, 1 i ndaluar dhe 1 ndiqet në gjendje të lirë.

Në vitin 2008 për veprën penale të “Trafikimit të fëmijëve” janë evidentuar 4 raste, me 5 autorë, 2 të arrestuar dhe 3 të ndaluar.

Në vitin 2009 për veprën penale të “Trafikimit të fëmijëve” janë evidentuar 3 raste me 4 autorë, 3 ndiqen në gjendje të lirë dhe 1 është shpallur në kërkim.

Në vite ka një rënie të rasteve të evidentuara, sidomos për sa i përket veprës penale të “Trafikimit të fëmijëve”, si dhe të personave të përfshirë në këto vepra penale.

Deri më tani ka pasur të dhëna zyrtare për shfrytëzim të fëmijëve në territorin shqiptar për turizëm seksual, me përjashtim të 1 rasti të një shtetasi britanik, i cili është dënuar për këtë veprë penale. Gjithashtu, nuk ka pasur as të dhëna për nxitjen brenda vendit të turizmit seksual me të mitur në vende të treta.

11. Ndërsa për veprën penale të “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese” në vitin 2006 është evidentuar një e dëmtuar e mitur. Është në zhvillim një proces penal kundrejt një shtetasi të huaj për veprën penale të shfrytëzimit seksual të disa të miturve në një jetimore.

12. Deri më tani nuk ka pasur raste në ndjekje për veprën penale të pornografisë që përfshin të miturit. Gjithashtu, nuk janë zbuluar raste të shpërndarjes së fotografive apo materialeve të tjera të shtypura, të videove, filmimeve apo materieve të tjera të regjistruara, të shfaqjeve të drejtpërdrejta që përfshihen në këtë veprë penale. Me gjithë angazhimin e madh, rezulton më i vështirë, për vetë zhvillimin teknologjik të vendit, kontrolli i faqeve internet me përmbajtje pornografike e fëmijëve.

III. Masa të përgjithshme për zbatimin e protokollit

13. Një listë e plotë e legjislacionit shqiptar në këtë fushë gjendet në dy raportet për Konventën për të Drejtat e Njeriut që janë paraqitur deri më tani. Më poshtë gjendet një listë e legjislacionit bazë:

Kodi Penal është legjislacioni bazë, i cili parashikon ndjekjen dhe dënimin e veprave penale të përfshira në këtë protokoll.

Kodi i Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, i ndryshuar.

Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr.9062, datë 8.5.2003, zë edhe ai një vend me rëndësi. Në të përfshihen parimet e përgjithshme të konventave, akteve dhe instrumenteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe veçanërisht ato të Konventës së OKB-së “Mbi mbrojtjen e fëmijëve”.

Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, i cili parashikon rregulla dhe norma ligjore, të cilat synojnë të sigurojnë që birësimet të bëhen në interesin e lartë të fëmijëve, duke respektuar të drejtat e tyre themelore.

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, lidhur me të drejtat e viktimave të dhunës në familje dhe garancitë e tyre procedurale”.

Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ligji nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.195, datë 11.4.2007 “Për standardet e shërbimeve për VET”.

b) Nuk ka.

c) Institucionet zyrtare që kanë për detyrë të realizojnë implementimin e këtij protokollit janë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme. Institucionet e pavarura që gjithashtu kanë për detyrë implementimin e këtij protokollit janë Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit dhe Komiteti Shqiptar i Birësimeve.

d) Protokollin, në momentin e ratifikimit në Parlament, është publikuar në Fletoren Zyrtare dhe kështu është vënë në dispozicion të publikut të gjerë. Dispozitat e tij pasqyrohen në legjislacionin shqiptar.

Aftësimi i personelit që zbaton këtë protokoll, konkretisht oficerët e policisë, gjyqtarët, punonjësit socialë, mësuesit dhe legjislatorët, kryhet nëpërmjet kurseve të aftësimit profesional të ndryshme dhe të vazhdueshme. Gjithashtu, kërkesat e këtij protokollit janë përfshirë në programet mësimore të formimit akademik dhe profesional të këtyre kategorive.

e) Kjo çështje shqyrtohet gjerë më poshtë, në përgjigjen për pikën 15.

g) Qeveria Shqiptare ka hartuar dhe po zbaton disa programe kombëtare për parandalimin e trafikimit, konkretisht, strategjinë kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2008-2010 dhe strategjinë kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit 2008-2010, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1083, datë 23.7.2008.

i) Në Shqipëri nuk ka një institucion të pavarur të posaçëm për mbrojtjen e fëmijëve. Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili është një organ i pavarur që ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të përgjithshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, ka synuar të japë një kontribut të veçantë në luftën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si me anë të trajtimit të ankesave individuale, ashtu edhe të hetimit me iniciativën e tij të rasteve të bëra publike, si dhe shqyrtimit të legjislacionit dhe dhënies së rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime të nevojshme në ligj. Që nga viti 2004, Avokati i Popullit ka krijuar një nënseksion të posaçëm për të drejtat e fëmijëve, me synim fitim përvoja dhe rritje të aftësisë së veprimt të tij në këtë fushë.

IV. Parandalimi (neni 9, paragrafët 1 dhe 2)

14. Në luftën kundër trafikimit, Qeveria Shqiptare ka nisur disa programe me qëllim parandalimin e trafikimit dhe ka hartuar dhe po implementon strategjinë kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2008-2010, si dhe strategjinë kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit 2008-2010, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1083, datë 23.7.2008.

Për implementimin e kësaj strategjie janë angazhuar institucionet qeveritare në nivel qendror (ministritë e linjës dhe institucionet e tyre vartëse) dhe institucionet në nivel vendor (prefekturat, bashkitë) në partneritet edhe me shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare, ofruesit e shërbimeve, institucionet akademike. Koordinimi kryhet nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar në Ministrinë e Brendshme.

Monitorimi i strategjive antitrafik kryhet aktualisht nga njësia antitrafik pranë Zyrës së Koordinatorit Kombëtar në Ministrinë e Brendshme, e ngritur me urdhër të kryeministrit nr.203, datë 19.12.2005.

Komititeti Shtetëror i Luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore, i kryesuar nga Ministri i Brendshëm; si dhe zyra e koordinatorës kombëtare/zëvendësministres së Brendshme për Antitrafikimin; e cila mbështetet nga njësia antitrafik, e cila ka për detyrë monitorimin e aktiviteteve të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e strategjisë; bashkërendimi i punës me këto institucione; mbledhja e informacioneve dhe të dhënave për çështje që lidhen me këtë fenomen etj.

Është ngritur mekanizmi kombëtar referues për fëmijët e trafikuar, si dhe janë ngritur komitetet rajonale të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore nën drejtimin e prefektit ku kanë detyra konkrete shkolla, Policia e Shtetit, SHSSH, shërbimi shëndetësor, sistemi i drejtësisë, OJF-të, familja, komuniteti.

Janë ngritur komitetet antitrafik në nivel, lokal, si dhe po konsolidohet roli i autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, i cili është ngritur me urdhër të Ministrit të Brendshëm, Ministrin të Punës dhe të Ministrin të Jashtëm. Detyra e autoritetit përgjegjës është mbrojtja fillestare, bashkërendim i procesit të referimit për ndihmë dhe rehabilitim afatgjatë për të gjitha viktimat e trafikut, në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera të përfshira dhe strehëzat që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikut.

Është ngritur baza elektronike e të dhënave, e cila mundëson përpunimin e të dhënave të sakta rreth trafikut të qenieve njerëzore në Shqipëri.

Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale në MPCSSHB regjistron të dhënat mbi rastet e viktimave të asistuar, të referuara, të trajtuara dhe të mbrojtura në qendrat që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit, si në Qendrën Kombëtare për Pritjen e VET-it në Linzë, dhe në qendra të tjera jopublike në kuadër të databazës të instaluar në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe të integruar në sistemin TIMS. Regjistrimi i të dhënave të viktimave/viktimave të hamendësuar të trafikimit ka filluar në korrik të vitit 2008.

U hartua draftudhëzuesi për zbatimin e standardeve të përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi. Udhëzuesi do të unifikojë praktikën dhe dokumentacionin në çdo institucion publik dhe privat që ofron shërbime për viktimat e trafikimit apo për persona në rrezik trafikimi.

U finalizua draftudhëzuesi për vënien në zbatim të “Mekanizmit transnacional të referimit (MTR) për viktimat e trafikimit (iniciativë e Ministrisë së Brendshme, MPCSSHB dhe pjesë të grupeve të punës). Është punuar për procedurat operative standarde (POS):

- për përkujdesjen gjatë ndërhyrjes në rast emergjence;
- ndihmë për rehabilitimin dhe riintegrimin e VET.

Në kuadër të parandalimit një instrument i rëndësishëm në duart e publikut tashmë është hapur dhe është funksionale 24 orë gjatë 7 ditëve të javës linja telefonike kombëtare pa pagesë “*help line*” (0800 12 12), si dhe shtrirja e përdorimit të kësaj linje telefonike pa pagesë “*help line*” për denoncimin e rasteve të trafikimit edhe për telefoninë celulare. Kjo linjë është në shërbim të të gjithë shoqërisë në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Ajo është në funksion të publikut që në muajin nëntor 2006. Janë bërë raportime të vazhdueshme periodike për rastet e denoncuar nga publiku. Ngritja e linjës fillimisht është mbështetur financiarisht nga UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet) dhe IOM. Që nga muaji nëntor 2007 dhe në vazhdim kjo linjë mbështetet financiarisht plotësisht nga Ministria e Brendshme.

Që nga 1 qershor 2009 funksionon edhe linja kombëtare e telefonit për fëmijët (116) dhe linja paneuropiane në ndihmë të fëmijëve (116 111), një shërbim profesional dhe i posaçëm për fëmijët, që ofrohet falas 24 orë në ditë në 7 ditë të javës nga UNICEF-i dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA / DCI Shqipëri). Në kohën e përgatitjes së këtij raporti linja i ishte përgjigjur më shumë se 100,000 telefonatave të fëmijëve, prindërve dhe mësuesve. Linja financohet gjatë vitit 2008-2010 nga zyra e UNICEF-it në Shqipëri.

Linja kombëtare e telefonit për fëmijët në Shqipëri ka si qëllim që të ofrojë këshillim psiko-social për fëmijët nëpërmjet telefonit, referimin e çdo problemi të fëmijës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, njësisive të mbrojtjes së fëmijëve në bashki dhe OJF-ve; të dëgjojë ankesat e

çdo fëmijë, i cili nuk ka mundësi që t'i shprehë ato në një formë tjetër.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare¹ ka vendosur në dispozicion të linjës dy numra telefoni për fëmijët: numri ALO 116 – Linja Kombëtare e telefonit për fëmijët dhe ALO 116 111 Linja paneuropiane e telefonit të fëmijëve në Shqipëri. Numri 116 dhe 116 111 gëzojnë cilësitë e një numri si ai i policisë apo urgjencës mjekësore.

Të gjitha përpjekjet parandaluese ndaj trafikimit lidhen ngushtë me përpjekjet për zhvillim ekonomik, arsimor, shëndetësor, punësim, lëvizje të lirë, ngritjen e sistemeve të mbrojtjes sociale, ulje të diskriminimit gjinor dhe minoriteteve etj. Gjithashtu një element tjetër i rëndësishëm që lidhet direkt me parandalimin e fenomenit të trafikimit është krijimi i kushteve për shanse të barabarta për grupet e marginalizuara të shoqërisë.

Për të përmbushur këtë qëllim, aktivitetet parandaluese të parashikuara në strategji synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe grupeve vulnerabël në veçanti mbi fenomenin, rritjen e mundësive për punësim, rritjen e numrit të fëmijëve, të cilët marrin një arsimim cilësor. Për të përmbushur këto objektiva është bërë e mundur rritja e kapaciteteve për agjencitë që ofrojnë ndihmë dhe orientim për punësim si për ato shtetërore, dhe ato private, janë zgjeruar programet që nxisin fëmijët të ndjekin shkollën, janë përmirësuar programet për arsimim profesional, janë rritur përpjekjet për zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese në vend lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, rreziqet e migracionit të parregullt dhe informim mbi rrugët për migracion të rregullt.

Komitetet rajonale antitrafik, të ngritura qysh prej vitit 2006 në 12 qarqet e vendit, kanë si detyrë të tyre parësore në fushën e parandalimit identifikimin e grupeve vulnerabël, analizimin e nevojave të tyre dhe hartimin e programeve për adresimin e këtyre problemeve në nivel lokal. Përgjatë këtij kapitulli do të gjeni një informacion mbi aktivitetet parandaluese të komiteteve rajonale antitrafik².

Arsimimi

Ministria e Arsimit dhe Shkencës në zbatim të strategjisë kombëtare antitrafik vazhdon përpjekjet për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijëve në shkollë, një detyrë e rëndësishme e këtij institucioni. Gjithashtu, vazhdon institucionalizimi i trajnimit të detyrueshëm kundër trafikimit duke e bërë pjesë të programit bazë të shkollës fillore, të mesme dhe shkollave të tjera parauniversitare dhe pjesë të programit të arsimit civil dhe gjinor (përfshi edhe çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, të drejtave të fëmijëve, barazisë gjinore dhe dhunës në familje, si edhe edukimin seksual).

Kurrikulat mësimore dhe temat mbi trafikimin

Kurrikula shkollore e arsimit parashkollor dhe 9-vjeçar është dokumenti bazë ku mbështetet i gjithë procesi mësimor edukativ në shkollë. Aktualisht, në arsimin bazë, kurrikula në bazë shkolle lejon trajtimin e tematikave të veçanta, me nxënësit ku natyrshëm përfshihet edhe informacioni për të drejtat e fëmijëve dhe sigurinë e tyre në shkollë dhe jashtë saj. Këtë vit shkollor hyri në fuqi arsimi i detyruar 9-vjeçar dhe u plotësua kurrikula e këtij arsimit. Në vitin 2009, në kuadër të realizimit të projektit “Barazi dhe cilësi në arsim” do të zhvillohet nga një konsulent i huaj “Vlerësimi i kurrikulës së arsimit bazë, klasa I – IX. Në përfundim të këtij vlerësimi do të bëhen ndërhyrjet e duhura për të përmirësuar këtë kurrikul. Ky do të jetë momenti kur do të rishikohet edhe përfshirja e tematikave të mësipërme.

Pjesëmarrja në arsimin e detyrueshëm

Në udhëzimin e fillimit të vitit të ri shkollor nr.32, datë 28.8.2009 udhëzohen të gjitha drejtoritë rajonale arsimore (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA) të marrin masa për uljen e numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe që kanë tendencë braktisjeje. Në zbatim të këtij udhëzimi në të gjitha drejtoritë rajonale arsimore dhe zyrat arsimore të vendit janë planifikuar dhe realizuar

¹ Vendim nr. 207/3 i datës 25.2.2009

² Informacionet e paraqitura lidhur me aktivitetet e komiteteve rajonale bazohen në informacionin e përcjellë nga vetë komitetet.

trajnime me mësues që punojnë me nxënës që kanë braktisur shkollën dhe që kanë tendenca braktisjeje.

Në nivel klase, shkolle atje ku problemi i braktisjes është prezent, mësuesit punojnë me programe të veçanta pune, me qëllim që të sensibilizojnë prindërit për rëndësinë e shkollimit. Sektorët e inspektimit në DAR inspektojnë të paktën dy herë në vit çdo ZA dhe shkollë që ka nxënës braktisës apo jashtë sistemit arsimor.

MASH ka punuar për hartimin dhe zbatimin e programeve për arsim alternativ dhe përvetësim të aftësive jetësore për fëmijët jashtë shkollave (përfshirë fëmijët e rrugës, romët, fëmijët me nevoja të veçanta etj.) dhe për jetimët (banorë dhe ish-banorë të shtëpive të fëmijës) që përgatiten për t'u larguar. Për të përmbushur këtë qëllim, MASH ndjek realizimin e projektit të "shansit të dytë". Në të gjithë vendin ka rreth 513 nxënës që ndjekin klasat e shansit të dytë në 29 shkolla. Mësimi që zhvillohet me këta fëmijë është plotësues, për të kapërcyer mangësitë që kanë dhe për t'i riintegruar në klasat e rregullta.

Sistemi i "mbrojtjes të fëmijëve" në shkolla

Një rëndësi të veçantë Strategjia kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore i jep institucionalizimit të një sistemi të "mbrojtësve të fëmijëve" në shkolla (bazuar në praktikat më të mira të TdH, ILO-IPEC, UNICEF, WV etj.), duke rritur kështu përkrahjen dhe këshillimin ndaj fëmijëve/të rinjve, për të dalluar rastet në rrezik dhe për të marrë masa me NJPF-të (njësitë për mbrojtjen e fëmijëve). Për këtë qëllim në prill të vitit 2008 me urdhrin nr.170 dhe udhëzimin nr.18, datë 21.4.2008 "Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar" të Ministrit të Arsimit, u legjitimua shtrirja e shërbimit psikologjik shkollor në arsimin parauniversitar, kopshte dhe shkolla. Pranë çdo shkolle ku funksionon shërbimi psikologjik shkollor (SHPSH), në ndihmë të psikologut është ngritur grupi mbështetës i psikologut që përbëhet nga drejtori, dy mësues dhe psikologu. Në nivel shkolle ky është grupi që trajton problemet e fëmijëve në rrezik trafikimi. Aktualisht, SHPSH shtrihet në të gjitha shkollat dhe kopshtet e qytetit dhe pjesërisht edhe në fshat. Deri tani, janë të punësuar gjithsej 190 psikologë.

Në kuadër të marrëveshjes që MASH ka me "*Terre des Hommes*", në 5 drejtori rajonale arsimore (DAR) të vendit po zhvillohet projekti "Përforcimi i rolit të shkollës në mbështetjen dhe mbrojtjen e fëmijëve brenda mjediseve të shkollës." Është hartuar manuali për mbrojtjen e fëmijëve dhe po zbatohet jo vetëm në shkollat e këtyre 5 DAR, por dhe më gjerë. Në projekt janë përfshirë 160 shkolla 9-vjeçare.

Janë zhvilluar:

- 147 seanca sensibilizuese me prindërit;
- 720 seanca sensibilizuese dhe këshilluese me nxënësit;
- 964 dosje janë hapur për fëmijët me probleme të mbrojtjes;
- 13 fëmijë janë referuar te strukturat e tjera lokale si njësia e mbrojtjes së fëmijëve në bashki, qendra shëndetësore etj.;
- 185 vizita janë kryer në familjet e fëmijëve me probleme.

MASH po punon që përvojën e mirë të krijuar në këto shkolla ta shtrijë më tej.

Regjistrimi i popullsisë

Në vitin 2008 u realizua krijimi i regjistrit kombëtar të gjendjes civile. Ky regjistër do të jetë burimi i vetëm i të dhënave për shtetasit shqiptar. Ky entitet do të bëjë të mundur pasqyrimin e drejtpërdrejtë të informacionit për çdo shtetas shqiptar në çdo dokument të plotësuar dhe lëshuar nga shërbimi i gjendjes civile. Regjistri kombëtar, si i vetmi burim të dhënash për shtetasit, rrit cilësinë e shërbimit dhe garancinë në cilësinë e saktësinë e të dhënave.

Shërbimi i gjendjes civile gjatë kësaj periudhe, përveç krijimit të RKGJC-së, është duke krijuar, në bashkëpunim me bashkitë/komunat edhe regjistrat vendor të adresave, të cilat do të jenë baza për krijimin e Regjistrat Kombëtar të Adresave.

Përveç këtij procesi, shërbimi i gjendjes civile ka treguar një vëmendje të veçantë edhe plotësimin të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me procesin e regjistrimit dhe

çregjistrimit të shtetasve. Për këtë qëllim është miratuar nga Parlamenti Shqiptar ligji i ri, nr.10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile". Ky ligj bën të mundur përmirësimin e procedurave për regjistrimin e lindjeve, duke bërë të mundur heqjen e pengesave ligjore, si p.sh. kalimin e afatit prej 45 ditë, nga dita e lindjes dhe vërtetimin e faktit të lindjes nëpërmjet gjykatës, pas kalimit të këtij afati.

Gjithashtu, procedurat për regjistrimin e lindjeve në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore kanë qenë dhe janë të parashikuara në ligjin për gjendjen civile. Në ligjin e ri është parashikuar që regjistrimi i akteve të lindjes të mund të bëhet dhe *on-line* nga këto zyra.

Regjistrimi i komunitetit rom

Si pjesë e procesit të regjistrimit të popullsisë, një rëndësi të veçantë i është dhënë regjistrimit të komunitetit rom. Për realizimin e procesit të pajisjes së shtetasve romë me letërnjoftim, Qeveria Shqiptare ka marrë angazhim për pajisjen e tyre me këtë dokument falas. Ky angazhim është formalizuar në vendimin nr.336, datë 15.4.2009 "Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtetasve në nevojë".

Për të përmirësuar procedurat e regjistrimit të lindjeve, është ndërmarrë një iniciativë ligjore, me anën e së cilës përmirësohet procedura e regjistrimit, pra sot jo vetëm që nuk ka afat kohor, i cili po të kalohet sjell pasoja administrative, por ligji parashikon bonus prej 5000 lekë, për të gjitha familjet që regjistrojnë lindjet brenda 60 ditëve. Kalimi i këtij afati nuk detyron që të bësh vërtetimin e lindjes në gjykatë, por regjistrimi vazhdon në rrugë administrative. Për të regjistruar një lindje, tashmë nuk është lënë vetëm në vullnetin e shtetasve të interesuar, por ligji ngarkon me përgjegjësi të gjitha institucionet publike dhe jopublike, që kanë detyrë për lindjen, që të bëjnë njoftimin e lindjes në zyrën e gjendjes civile përkatëse/DPGJC. Kjo masë për më së shumti ka ndihmuar kategorinë e romëve, të cilët për arsye nga më të ndryshmet nuk kryenin regjistrimin në kohën e kufizuar që parashikonte ligji dhe akoma më tepër kur vinte puna për ta vërtetuar lindjen me vendim gjykatë. Nga ana tjetër, Ministria e Brendshme ka hartuar një projekt "Për identifikimin dhe regjistrimin e romëve të paregjistruar". Ky projekt ka në themel një lloj "*CENSIUSI*" në zonat ku banojnë romët dhe do të kryhet në bashkëpunim të plotë me shoqatat Rome.

Shfrytëzimi i punës së fëmijëve

Krijimi i një sistemi monitorues shumëdisiplinor për mbrojtjen e fëmijëve, dhe konkretisht mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi për punë, ka qenë një objekt i rëndësishëm i punës së njësisë antitrafik. Njësia antitrafik është përpjekur të ndërjegjësojë agjencitë shtetërore mbi këtë fenomen të rëndë social, shfrytëzimi i punës së fëmijëve si policia, inspektorët e punës, strukturat e qeverisjes vendore, OJF-të e komunitetit për të identifikuar fëmijët e shfrytëzuar apo në rrezik shfrytëzimi.

Në kuadrin e memorandumit të mirëkuptimit që MPÇSSHB ka nënshkruar me ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës) është miratuar projekti: "Sistemi i monitorimit të punës së Fëmijëve në Shqipëri", i cili do të pilotohet në pesë bashki: Tiranë, Korçë, Berat, Elbasan dhe Shkodër, me qëllim parandalimin e fenomenit dhe mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në punë të rrezikshme. Në këtë kuadër në tre drejtoritë rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës: Tiranë, Korçë dhe Berat do të krijohen komitetet lokale me synim parandalimin e fenomenit të punës së fëmijëve, tërheqjen nga puna të fëmijëve që punojnë duke siguruar alternativa më të përshtatshme dhe në interes të tyre.

Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP)³:

Një nga objektivat e Inspektoratit Shtetëror të Punës është kontrolli i punës së fëmijëve. Nga inspektimet e kryera në periudhën shtator 2008 – prill 2009 rezultojnë të dhënat si më poshtë vijon.

Sipas moshës, rezultojnë se fëmijë të evidentuar në punë janë kryesisht ata të moshës:

- 17 vjeç me 54.3%;

- 16 vjeç me 18.3%;

³ Burimi i të dhënave: Inspektorati Shtetëror i Punës

- 15-vjeç me 1.9%.

Nga fëmijët e evidentuar në punë rezultojnë se pjesa më e madhe është e seksit femër dhe konkretisht 82.6% e të gjithë fëmijëve janë vajza.

Fëmijë të punësuar sipas llojit të aktivitetit:

- Bujqësi, pyje, peshkim - 23%;

- Ndërmarrje prodhuese – 63.7% (rrobaqepësi - 49.5 faqe këpucësh -15.7%);

- Ndërtim - 1.8%;

- Aktivitete të tjera - 11.5%.

Gjatë inspektimeve rezultojnë se janë evidentuar 86% e fëmijëve që punojnë të siguarur dhe 14% e tyre nuk ishin të siguarur në momentin e kontrollit. Sigurisht që për këta fëmijë janë marrë masat për sigurimin e tyre pranë zyrave të tatim-taksave. 78% e fëmijëve të evidentuar janë me ekzaminim mjekësor. Për pjesën tjetër janë informuar punëdhënësit dhe janë lënë detyra konkrete në lidhje me ekzaminimin mjekësor në varësi të vendit të punës, ku punojnë këta fëmijë.

Arsimimi i fëmijëve të punësuar:

Nga fëmijët e evidentuar rezultojnë:

- 5.4% me arsim fillor;

- 90% me arsim 8-vjeçar;

- 4.6% me arsim të mesëm.

Masat që janë marrë nga ISHP-ja

Në kuadër të ndryshimeve që do të pësojë Kodi i Punës, janë përgatitur 2 projektvendime:

1. Për përcaktimin e kontrollit mjekësor për punëmarrësit e mitur nën 18 vjeç para fillimit të marrëdhënieve të punës;

2. Për përcaktimin e orëve të punës, të cilët s’duhet të kalojnë 48 orë në javë, përfshirë në këtë dhe orët suplementare në vendet e punës që paraqesin rrezik.

Në dokumentin politik të strategjisë dhe shëndetit në punë është parë me prioritet mbrojtja e kësaj kategorie të punësuarish.

Në projektligjin që po përgatitet (për sigurinë dhe shëndetin në punë), janë parashikuar dispozita të veçanta për mbrojtjen e të miturve në punë, si dhe parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Është zhvilluar një tryezë e rrumbullakët për mbrojtjen e të miturve në punë, ku marrin pjesë përfaqësues të sindikatës, të konfederatës të punëdhënësve, punëmarrësve.

Ambasadat shqiptare si mekanizma ndihmës në parandalimin e rasteve të trafikimit

Janë trajnuar punonjësit e konsullatave, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të evidentojnë imigrantët, të cilët mund të jenë në rrezik dhe të japin informacion pa shkelur të drejtat e njeriut, apo të tërheqin vizat e tyre për dyshim trafikimi. Janë përgatitur broshura informative lidhur me shërbimet që u ofrohen shtetasve nga përfaqësitë tonë (në bashkëpunim me IOM) në kuadrin e fushatës informative të parashikuar në strategjinë kombëtare për migracionin.

Vazhdimi i funksionimit të linjës kombëtare telefonike falas dhe bashkëpunimi me linjat telefonike për dhunën në familje, për të përfshirë ndërgjegjësimin mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe shërbimet në dispozicion. Pranë sektorit të marrëdhënieve me publikun në drejtorinë konsullore është parashikuar vendosja e një numri telefoni për kontakte të drejtpërdrejta me publikun. Sektori në fjalë është ndërkohë aktivisht i përfshirë në trajtimin apo paraqitjen e dërgesave, rasteve dhe denoncimeve të mundshme.

Ngritje kapacitetesh për forcimin e mekanizmave koordinues dhe referues për identifikimin e personave në rrezik në nivel lokal

Strategjia kërkon që të institucionalizohen mekanizmat e mbrojtjes dhe parandalues, si dhe mekanizmat e përkrahjes në nivel vendor për grupet në nevojë dhe në rrezik trafikimi. Strategjia parashikon krijimin dhe forcimin e mekanizmave koordinues dhe referues për identifikimin e personave në rrezik dhe sigurimin e ndërhyrjeve parandaluese dhe mbështetëse si pjesë e “mekanizmit kombëtar të referimit. Për të siguarur një mbrojtje/mbështetje sa më të mirë të

personave të kategorisë në rrezik trafikimi, është i domosdoshëm sigurimi i shërbimeve të përshtatshme dhe i mbështetjes për grupet dhe personat në nevojë dhe në rrezik.

Koordinatori Kombëtar dhe njësi antitrafik kanë bërë të mundur zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme për të arritur sensibilizimin e të gjitha subjekteve më të mëdha shtetërore të shërbimeve për çështjet e antitrafikimit (policia, subjektet e qeverisjes vendore, punonjësit socialë, etj.).

Aktivitetet lokale - komitetet rajonale antitrafik (KRAT)

Në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar që autoritetet vendore jo vetëm të identifikojnë numrin e familjeve me probleme sociale dhe fëmijët të cilët kanë braktisur shkollën, por dhe të bëjnë një analizë të shkaqeve, dhe më pas në bazë të rezultateve të analizës të identifikojnë masat, të cilat duhen marrë për të përmirësuar situatën.

KRAT-et, nëpërmjet drejtorive arsimore, kanë përcjellë informacion pranë ZKKA-së për numrin e fëmijëve që kanë braktisur shkollën, shkaqet, si dhe masat e marra për përfshirjen e tyre në shkollë. Një punë e mirë në këtë drejtim është bërë në të gjitha qarqet e vendit në zbatim edhe të programit të MASH-it "Shansi i dytë". Drejtoritë rajonale arsimore dhe zyrat arsimore kanë punuar me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit nëpërmjet procesit mësimor-edukativ për ndalimin e fenomenit të trafikimit, përmes pjesëmarrjes aktive të nxënësve duke pasur si prioritet respektimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë.

Gjithashtu, është punuar edhe me programe të veçanta për arsimin alternativ, duke përfshirë fëmijët e rrugës, romët, fëmijët me nevoja të veçanta, jetimët etj. Një ndihmesë të madhe në veprimtarinë e KRAT-ve kanë dhënë edhe qendrat dhe OJF-të, të cilat në veprimtaritë e tyre kanë në fokus parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi nëpërmjet seancave edukuese me të rinj në të cilat janë trajtuar tema të ndryshme mbi dhunën në familje, trafikimin, diskriminimet, paragjykimet, droga etj. Është dhënë ndihmë dhe këshillim në shkollat që kanë fëmijë nga komuniteti rom, apo dhe fëmijët e rrugës, të punësuar në punë të zezë etj. Në vitin shkollor 2008-2009, drejtoritë arsimore në të gjitha qarqet kanë marrë masa për ngritjen dhe vënien në funksionim të linjave që bëjnë transportin e nxënësve për në shkollë dhe anasjelltas.

Punësimi është një instrument shumë i rëndësishëm parandalues për fenomenin e trafikimit. Komitetet rajonale antitrafik dhe përkatësisht zyrat rajonale të punës (të përfaqësuara në komitetet rajonale antitrafik) duhet të kenë informacion të përditësuar mbi numrin e personave të cilët janë identifikuar si të papunë dhe në bashkëpunim me MPCS-SHB-në të hartojnë programe të cilat nxisin punësimin dhe rrisin aftësitë për punë të punëkërkuarve në vend. KRAT-et nëpërmjet zyrave rajonale të punësimit i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë si monitorimit dhe vlerësimit të tregut të punës, ashtu edhe identifikimit të personave të papunë, si dhe janë marrë masa për punësimin e punëkërkuarve të papunë në mënyrë të veçantë punëkërkuarset e papuna femra që janë edhe më të rrezikuara nga trafikimi. Zyrat rajonale të punësimit në bashkëpunim edhe me anëtarët e tjerë të KRAT-eve kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur kapacitetin dhe efikasitetin e tyre për trajnimin dhe formimin profesional të personave, duke pasur parasysh nevojat e tregut të punës.

15. Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere të vazhdueshme është një mënyrë e mirë për t'u siguruar që publiku, e sidomos grupet vulnerabël, janë të mirinformuar mbi shkaqet dhe pasojat e fenomenit të trafikimit në vend. Fushatat kanë synuar grupet në rrezik, si dhe aktorët që punojnë me këto grupe, synohet që në të ardhmen gama e këtyre fushatave të zgjerohet edhe për shfrytëzuesit e mundshëm.

Fushatat kanë bërë të mundur që pjesëmarrësit të kuptojnë çfarë është trafikimi i qenieve njerëzore, të jenë të aftë të identifikojnë qëllimet pse trafikohen personat dhe rrugët kryesore nëpërmjet të cilave rekrutohen njerëzit. Pjesëmarrësit gjithashtu kanë marrë informacion mbi realitetet, rreziqet dhe të mirat e migracionit të rregullt. Gjithashtu, është synuar që mesazhi të përcjellë promovimin e nismave arsimore dhe të arsimit profesional si alternativë ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit. Gjatë periudhës së raportimit grupi më i shënjestruar ka qenë grupmosha e re, 14-18 vjeç.

Koordinatori Kombëtar dhe njësia antitrafik kanë monitoruar nga afër këto fushata ndërgjegjësuese, në mënyrë që ato të jenë të mirëkoordinuara dhe të harmonizuara dhe kanë siguruar që mesazhet e përcjella të jenë jostigmatizuese dhe informacioni i përcjellë të jetë i përditësuar.

a) Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të inkurajuar autoritetet arsimore për institucionalizimin e temave ndërgjegjësuese mbi trafikimin si pjesë të kurrikulave mësimore, në mënyrë që informacioni që i përcillet të rinjve mbi këtë fenomen të jetë i vazhdueshëm dhe i përditësuar. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë të mundur përfshirjen e temave antitrafik në kurrikulat e lëndëve që trajtojnë temat sociale dhe gjinore dhe janë marrë masa konkrete që në publikimet speciale për mësuesit, të nxirren udhëzime të cilat udhëzojnë mësuesit që t'i japin prioritetet çështjeve gjinore, trafikimit dhe dhunës në familje gjatë orës së mësimi apo në aktivitete të tjera jashtëshkollore.

Gjithashtu, është ngritur edhe një linjë kombëtare për fëmijët. Linja kombëtare për fëmijët në Shqipëri është një iniciativë e përbashkët e UNICEF-it dhe Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri/Mbrojtja Ndërkombëtare e Fëmijëve (CRCA/DCI Shqipëri). Linja kombëtare është përgjegjëse për dhënien e shërbimeve në tre numra telefoni: 116000, 116111 dhe 116123, për të gjithë fëmijët, që ndodhen në Shqipëri, pavarësisht nga kombësia e tyre. Kjo linjë është në dispozicion jo vetëm të fëmijëve shqiptarë, por edhe atyre evropianë, kur ata ndodhen në Shqipëri. Linja kombëtare për fëmijë, ka filluar të funksionojë në fillim të vitit 2009. Personat, të cilët operojnë këtë linjë telefonike, i përgjigjen telefonatave të fëmijëve nga e gjithë Shqipëria në mënyrë të kualifikuar dhe profesionale, 24 orë në ditë, gjatë 7 ditëve të javës.

Kjo linjë është në dispozicion të më shumë se 1 milion fëmijëve në të gjithë Shqipërinë, 24 orë, gjatë 7 ditëve të javës, pa pagesë dhe e mundur për t'u aksesuar si nga numrat fiks, edhe nga ata celularë.

b) Për sa i përket ndërgjegjësimit publik, komitetet rajonale antitrafik - KRAT kanë zhvilluar një sërë aktivitete të ndihmuar edhe nga OJF-të dhe mediat lokale, janë zhvilluar debate televizive kundër dhunës në familje dhe për probleme të tjera lidhur me trafikimin, si: janë zhvilluar fushata për ndërgjegjësimin sidomos për grupet e veçanta (romët, fëmijët e rrugës, gratë dhe vajzat e reja, si dhe familjet me probleme social-ekonomike), si dhe janë publikuar dhe janë shpërndarë materiale dhe fletëpalosje me tematikë edukuese dhe ndërgjegjësuese.

Gjatë vitit 2009 një rëndësi të veçantë iu dha sensibilizimit të strukturave qeveritare në nivel qendror dhe vendor, medias, opinionit publik në përgjithësi për njohjen dhe zbatimin e strategjisë kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe dokumentit plotësues "Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve viktime të trafikimit".

U ndoqën takimet në kuadër të ditës evropiane kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Ndërkombëtar u organizuan aktivitete për sensibilizimin e opinionit, të aktorëve që kanë angazhime të drejtpërdrejta në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

d) Nuk ka ende studime mbi statistikat edhe pse ato, në vështrim të parë, dëshmojnë ecuri pozitive.

V. Ndalimi dhe çështje të lidhura me të (nenet 3, 4, paragrafët 3, 5, 6 dhe 7).

16. Dispozitat në Kodin Penal që dënojnë: a) shitjen, b) prostitucionin dhe c) pornografinë e fëmijëve janë:

Neni 128/b "Trafikimi i të miturve"

Paragrafi i parë i këtij neni përkufizon: rekrutimin, shitjen, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës, të shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Ndërsa në paragrafin e tretë të këtij neni (128/b/3) është parashikuar bashkëpunimi në këtë vepër penale si një rrethanë rënduese.

Neni 113 “Prostitucioni” dhe neni 114 “Shfrytëzimi i prostitucionit”

Nenet e mësipërme bëjnë përkufizimin e ushtrimit dhe shfrytëzimit të prostitucionit si vepër penale në përgjithësi, ndërsa shfrytëzimi i të miturve në prostitucion është parashikuar si rrethanë rënduese në nenin 114/a/1.

Bashkëpunimi për kryerjen e kësaj vepre penale është parashikuar po në nenin 114/a/6, ku thuhet se:

“kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose me shumë se një herë ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike dënohet nga 7 deri në 15 vjet burgim”.

Neni 117 “Pornografia”

Paragrafi i parë i këtij neni (117/1) përkufizon prodhimin, shpërndarjen, reklamimin, importimin, shitjen e botimin e materialeve pornografike në ambientet e të miturve.

Ndërsa në paragrafin e dytë (117/2) përkufizohet përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarjen ose publikimin e këtyre materialeve në internet apo në forma të tjera.

Dispozitat që dënojnë dërgimin, dhurimin apo pranimin e fëmijëve me qëllim shfrytëzimin seksual, marrjen e organeve për përfitim material dhe angazhimin e tij në punë të detyruar janë:

Neni 128/b “Trafikimi i të miturve” përmendet se: “Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga 7- 15 vjet dhe me gjobë nga 4-6 milionë lekë.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohet me burgim nga 10-20 vjet dhe me gjobë nga 6-8 milionë lekë.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo me pak se 15 vjet dhe me gjobë nga 6-8 milion lekë.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga 8-10 milionë lekë.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.”.

Njëkohësisht edhe nenet e mëposhtme të Kodit Penal dënojnë dërgimin, dhurimin apo pranimin e fëmijëve me qëllim shfrytëzimin etj., si më poshtë:

Neni 113 “Prostitucioni”: “Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet”.

Neni 114 “Shfrytëzimi i prostitucionit” në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë thuhet se: Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 vjet.” Gjithashtu, theksohet se kur kjo vepër kryhet ndaj një të miture ose me anë të përdorimit të dhunës, dënohet me burgim nga 5- 10 vjet.

Neni 114/a “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”,

“Shfrytëzimi i prostitucionit i kryer:

1. me të mitur;
2. ndaj disa personave;
3. me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie ose duke përfituar nga raportet zyrtare;
4. me mashtrim, shtrëngim, dhunë ose duke përfituar nga paaftësia fizike ose mendore e personit;

5. ndaj një personi që shtyhet ose shtrëngohet për të ushtruar prostitucion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

6. kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike;

- dënohet nga 7- 15 vjet burgim”.

Dispozitat ligjore kombëtare që dënojnë tentativën apo bashkëpunimin për të kryer aktet e sipërshënuara janë:

Dispozitat ligjore, të cilat parashikojnë dhe dënojnë tentativën dhe bashkëpunimin, janë të parashikuara në Kodin Penal si më poshtë:

Neni 22 (kuptimi i tentativës) bën përkufizimin veprës penale të mbetur në tentativë, ku thuhet: “Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.”

Ndërsa neni 23 “Përgjegjësia për tentativën”përcakton përgjegjësinë për tentativën si më poshtë:

“Personi që tenton të kryejë një krim përgjigjet për të dhe gjykata, në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës, si dhe të shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, zbut dënimin dhe mund ta ulë atë nën minimumin e parashikuar nga ligji ose të caktojë një lloj dënimi më të butë nga ai i parashikuar në ligj.”.

Neni 25 “Kuptimi i bashkëpunimit”, i cili bën përkufizimin veprës penale të bashkëpunimit, ku thuhet: “Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.”

Ndërsa neni 26 i Kodit Penal jep përkufizimi e bashkëpunëtorëve, ku bashkëpunëtorë për kryerjen e veprës penale quhen: organizatorët, ekzekutorët, shtytësit dhe ndihmësit.

“Organizatorë quhen ata persona që organizojnë dhe drejtojnë veprimtarinë për kryerjen e veprës penale. Ekzekutorë janë personat që kryejnë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale. Shtytës quhen personat që nxisin bashkëpunëtorët e tjerë për kryerjen e veprës penale. Ndihmës quhen personat që me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh, largim të pengesave, dhënie të premtimit për fshehjen e bashkëpunëtorëve, të gjurmëve apo të sendeve që rrjedhin nga vepra penale, ndihmojnë për kryerjen e saj.”.

Neni 27 “Përgjegjësia e bashkëpunëtorëve”

“Organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit kanë përgjegjësi, si edhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre. Në caktimin e dënimit për bashkëpunëtorët, gjykata duhet të mbajë parasysh shkallën e pjesëmarrjes së secilit dhe rolin e luajtur në kryerjen e veprës penale.”.

Neni 50 (germa “gj”)

Përcakton se, një ndër rrethanat rënduese në caktimin e masën e dënimit për një veprë penale edhe kryerjen e veprës në bashkëpunim.

Dënimet për krimet e mësipërme dhe rrethanat rënduese janë:

Dënimet e parashikuara në Kodin Penal për veprat penale të shitjes, prostitucionit dhe pornografisë së fëmijëve janë:

Për veprat penale të parashikuara nga neni 114/a/1 (shfrytëzimi i prostitucionit i kryer me të mitur) dënim me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Për veprat penale të parashikuara nga neni 128/b (shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual) dënim me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milionë deri në gjashtë milionë lekë.

Për veprat penale të parashikuara nga neni 124/a (kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit) dënim me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga 300 mijë lekë deri në 3 milionë lekë.

Për veprat penale të parashikuara nga neni 117 (përdorimin e të miturit; për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i këtyre materialeve tyre në internet apo në forma të tjera), dënim me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.

Njëkohësisht në nenin 50 të Kodit Penal janë përcaktuar dhe rrethanat rënduese për veprat penale në tërësi.

17. Legjislacioni shqiptar dhe politikat sociale të tij janë në përmirësim të vazhdueshëm për shkak të përmbushjes graduale dhe të shpejtë që Shqipëria po i bën detyrimeve që dalin nga procesi i integritetit në BE.

18. Përcaktimi i përgjegjësisë penale për personat ligjorë, trajtohet në kreun e II të Kodit Penal dhe konkretisht:

Neni 12 përcakton moshën për përgjegjësi penale, sipas të cilit përgjegjësia penale:

-për krime fillon në moshën 14 vjeç;

-për kundërvajtje penale fillon në moshën 16 vjeç.

Nenet 17, 19, 20 dhe 21 të Kodit Penal, përcaktojnë rastet përjashtimore për të cilat personat nuk mbajnë përgjegjësi penale, të cilat janë:

- papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore;

- mbrojtja e nevojshme;

- nevoja ekstreme;

- ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës.

19. Masat ligjore, administrative dhe gjyqësore të ndërmarra për të siguruar që birësimet e fëmijëve të kryhen në përputhje me instrumentet ndërkombëtare ligjore të aplikueshme.

Nisur nga nevoja e përafrimit të politikave mbështetëse për fëmijët dhe legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare, shteti ynë ka marrë një sërë masash për të siguruar që birësimet e fëmijëve të kryen në përputhje me instrumentet ndërkombëtare. Shteti shqiptar, me ligjin nr.8624, datë 15.6.2000 ka aderuar në Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”, qëllimi i së cilës është marrja e masave mbrojtëse për të siguruar që birësimet të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës, duke respektuar të drejtat e tij themelore.

Gjithashtu të krijojë një sistem bashkëpunimi midis shteteve për të siguruar që këto masa të respektohen dhe në këtë mënyrë të parandalohen rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve.

Mjaft i rëndësishëm është miratimi i Kodit të Familjes, që në parimet e tij udhëhiqet nga interesi më i lartë i fëmijës në të gjitha procedurat ligjore dhe veçanërisht ato të birësimit, duke garantuar të drejtat e tij themelore.

Mbrojtja e fëmijëve nëpërmjet birësimit kalon në dy procedura, administrative dhe gjyqësore.

Duke ndjekur parimet e Konventës së Hagës është miratuar ligji nr.9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”. Miratimi i këtij ligji zhvillon marrëdhëniet institucionale, ofron procedura lehtësuese dhe të sakta për realizimin e birësimeve nga organet kompetente, si dhe krijon një sistem kontrollues mbi situatën e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga fenomene që paraqesin rrezikshmëri për të ardhmen. Gjithashtu ai përcakton Komitetin si Autoritet kompetent për realizimin e procedurave administrative. Ky Komitet ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet vendosjes së përhershme në një familje birësuese, si dhe ndjekjen e ecurisë pasbirësuese të fëmijëve në familjen birësuese.

Pas procedurës administrative Kodi i Familjes ka parashikuar procedurën gjyqësore, ku gjykatat bëjnë një hetim të plotë të të gjithë procedurës administrative duke ligjëruar birësimin.

Dispozitat që dënojnë rolin e ndërmjetësit në birësimet e një fëmije në kundërshtim me instrumentet ndërkombëtare ligjore lidhur me birësimin janë:

Neni 124/a “Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit”

Ky nen përkufizon si vepër penale të gjitha veprimet si: kërkimin, propozimin, dhënien ose pranimin e shpërblimeve dhe përfitimeve të tjera, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me procesin e birësimit të një të mituri.

Për veprat penale të parashikuara nga neni 124/a (kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit) dënim me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga 300 mijë lekë deri në 3 milionë lekë.

Neni 128/b “Trafikimi i të miturve”

Paragrafi i parë i këtij neni përkufizon: rekrutimin, shitjen, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Për veprat penale të parashikuara nga neni 128/b (shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual) dënim me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milionë deri në gjashtë milionë lekë.

20. Vendi ynë është palë në këtë Konventë që në vitin 2000.

21. Në nenin 117 të Kodit Penal parashikon se prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në ambientet e të miturve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Gjithashtu në paragrafin e dytë të këtij neni është parashikuar se përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i tyre në internet apo në forma të tjera, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.

22. Masat ligjore në lidhje me përcaktimin e juridiksionit, janë përcaktuar në nenet 5, 6, 7 dhe 7/a të Kodit Penal, si më poshtë:

Neni 5 “Territori i Republikës së Shqipërisë”: “Territori i Republikës së Shqipërisë, në kuptim të ligjit penal, quhet hapësira tokësore, gjerësia e ujërave territoriale dhe të brendshme detare, hapësira ajrore që shtrihet mbi hapësirën tokësore dhe të ujërave territoriale dhe të brendshme detare, si dhe çdo vend tjetër ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqiptar, si selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare, anijet që mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë, anijet e marinës luftarake, të aviacionit ushtarak ose civil kudo që ndodhen.”

Në nenin 6 “Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë”:

“Për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë zbatohet ligji penal i Republikës së Shqipërisë. Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen krim në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj. Në kuptim të këtij neni shtetas shqiptarë do të konsiderohen edhe ata persona që përveç shtetësisë shqiptare gëzojnë edhe shtetësi tjetër.”

Neni 7 “Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj”:

“Shtetasi i huaj, që kryen vepër penale në territorin e Republikës së Shqipërisë, përgjigjet në bazë të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë. Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj që jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryen në dëm të interesave të shtetit ose të shtetasit shqiptar një nga krimet e mëposhtme:

... d) organizimi i prostitucionit, prodhimi dhe trafiku i jashtëligjshëm i njerëzve, fëmijëve, grave, prodhimi dhe trafikimi i jashtëligjshëm i armëve, drogës, substancave të tjera narkotike e psikotrope, substancave bërthamore, i materialeve pornografike, si dhe trafikimi i jashtëligjshëm i veprave të artit dhe i objekteve me vlerë historike;

... g) krime që cenojnë jetën dhe shëndetin e shtetasit shqiptar, për të cilat ligji parashikon dënim mbi pesë vjet burgim ose çdo lloj dënimi më të rëndë.”

23. Dispozita ligjore që parashikon shtrirjen e efektit të ligjit penal ndaj personave me shtetësi shqiptare, që gjenden në territorin e vendit tonë, por që kanë kryer një krim në një vend tjetër, janë parashikuar në nenin 6 “Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë” paragrafi i dytë (6/2) i Kodit Penal si më poshtë:

“Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen krim në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj.

Në kuptim të këtij neni shtetas shqiptarë do të konsiderohen edhe ata persona që përveç shtetësisë shqiptare gëzojnë edhe shtetësi tjetër.”.

24. Dispozitat ligjore të legjislacionit të brendshëm që lejojnë ekstradimin e shtetasve nga shtetet palë në këtë protokoll janë:

-Ekstradimi, për këtë kategori krimesh, është parashikuar nga marrëveshjet e ekstradimit.

-Kur ky protokoll ka vlerën e një marrëveshjeje ekstradimi.

-Ekstradimi nuk kushtëzohet nga ekzistenca e një marrëveshjeje.

Në Kodin Penal të RSH-së, neni 11 “Ekstradimi” përcaktohet se kur lejohet ekstradimi dhe kur nuk lejohet si më poshtë:

“Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Ekstradimi lejohet kur vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim është e parashikuar si e tillë njëkohësisht si nga ligji shqiptar dhe ai i huaj.

Ekstradimi nuk lejohet:

a) në qoftë se personi që do të ekstradohet është shtetas shqiptar, veç rasteve kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe;

b) në qoftë se vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim ka një karakter politik ose ushtarak;

c) kur ka arsye për të dyshuar që personi i kërkuar të ekstradohet do të persekutohet, dënohet ose kërkohet për arsye të bindjeve të tija politike, fetare, kombëtare, racore ose etnike.

d) në qoftë se personi që kërkohet të ekstradohet është gjykuar nga një gjykatë kompetente shqiptare për veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi.”

-Ekstradimi dhe mënyrat e realizimit të tij janë parashikuar në ligj.

Neni 504 i Kodit të Procedurës Penale “Kërkesa për ekstradim” përcakton procedurat që ndiqen, ku në këtë nen thuhet se:

“1. Ministria e Drejtësisë është kompetente që t'i kërkojë një shteti të huaj ekstradimin e një personi të proceduar ose të dënuar penalisht, ndaj të cilit duhet të ekzekutohet një masë që kufizon lirinë personale. Për këtë, prokurori pranë gjykatës në territorin e së cilës procedohet ose është dhënë vendim dënimi, i bën kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, duke i dërguar aktet dhe dokumentet e nevojshme. Kur nuk e pranon kërkesën, Ministria njofton autoritetin që e ka bërë atë.

2. Ministria e Drejtësisë është kompetente të vendosë në lidhje me kushtet e vëna eventualisht nga shteti i huaj për të dhënë ekstradimin, kur ato nuk vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Autoriteti procedues detyrohet të respektojë kushtet e pranuar.

3. Ministria e Drejtësisë mund të vendosë, për qëllimet e ekstradimit, kërkimin jashtë shtetit të personit të proceduar ose të dënuar dhe arrestimin e tij të përkohshëm.

4. Paraburgimi jashtë shtetit, si rrjedhojë e në kërkesë ekstradimi të paraqitur nga shteti shqiptar, llogaritet në kohëzgjatjen e paraburgimit, sipas rregullave të caktuara në titullin V të këtij kodi.”

-Për këtë kategori krimesh, i pandehuri ka përgjegjësi penale si në vendin ku ka kryer krimin ashtu dhe në vendin e origjinës së tij.

Në nenin 488 të Kodit të Procedurës Penale “Kuptimi i ekstradimit” thuhet se: “Dorëzimi i një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale, mund të bëhet vetëm nëpërmjet ekstradimit.”.

Ndërsa në nenin 489 të Kodit të Procedurës Penale “Kërkesa për ekstradim” thuhet se:

1. Ekstradimi lejohet vetëm mbi bazën e një kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

2. Kërkesës për ekstradim i bashkëngjiten:

a) kopja e vendimit të dënimit me burgim ose e aktit të procedimit;

b) një relacion mbi veprën penale që i ngarkohet personit për të cilin kërkohet ekstradimi, duke treguar kohën dhe vendin e kryerjes së veprës dhe cilësimin ligjor të saj;

c) teksti i dispozitave ligjore që do të zbatohen, duke treguar nëse për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi është parashikuar nga ligji i shtetit të huaj dënimi me vdekje;

ç) të dhënat individuale dhe çdo informacion tjetër të mundshëm që shërben për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e personit, për të cilin kërkohet ekstradimi.

3. Kur konkurrojnë disa kërkesa ekstradimi, Ministria e Drejtësisë cakton radhën e shqyrtimit. Për këtë qëllim ajo mban parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe veçanërisht datën e marrjes së kërkesës, rëndësinë dhe vendin e kryerjes së veprës penale ose shtetësinë dhe vendbanimin e personit të kërkuar, si dhe mundësinë e një riekstradimi nga shteti kërkues.

4. Në qoftë se për një shkelje të vetme ekstradimi kërkohet në të njëjtën kohë nga shumë shtete, ai i jepet shtetit ndaj të cilit është drejtuar vepra penale ose atij shteti mbi territorin e të cilit është kryer vepra.”.

“Neni 490 i Kodit të Procedurës Penale “Kushtet e ekstradimit”:

1. Ekstradimi lejohet me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.

2. Kushtet e treguara nga paragrafi 1 nuk merren parasysh:

a) kur pala dorëzuese jep pëlqim të shprehur që i ekstraduari të ndiqet edhe për një vepër penale tjetër dhe i ekstraduari nuk ka kundërshtim;

b) kur i ekstraduari, edhe pse ka pasur mundësi, nuk ka lënë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar, pasi kanë kaluar dyzet e pesë ditë nga lirimi i tij ose pasi e ka lënë atë është kthyer vullnetarisht.

3. Ministria e Drejtësisë mund të vërë edhe kushte të tjera që i çmon të përshtatshme.”.

“Neni 491 i Kodit të Procedurës Penale “Mospranimi i kërkesës për ekstradim”:

“1. Nuk mund të jepet ekstradimi:

a) për një vepër me karakter politik ose kur rezulton që ai kërkohet për qëllime politike;

b) kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut;

c) kur personi që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri;

ç) kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit;

d) kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar;

e) kur për veprën penale është dhënë amnisti nga shteti shqiptar;

f) kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe;

g) kur është parashikuar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit që e kërkon.”.

Në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me shitjen, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë janë parashikuar si vepra penale, në nenet si vijojnë:

Në nenin 114/a të Kodit Penal parashikohet si një ndër rrethanat rënduese të veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit kryerja e kësaj vepre me të mitur, e cila dënohet nga 7 deri në 15 vjet burgim.

Në nenin 128/b të Kodit Penal është parashikuar “trafikimi i të miturve” me këtë përmbajtje:

- Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga 7 deri në 15 vjet dhe me gjobë nga 4 milionë deri në 6 milionë lekë.

- Në paragrafin e dytë të këtij neni parashikohet se: organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga 10 deri në 20 vjet dhe me gjobë nga 6 milion deri në 8 milionë lekë.

- Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim dhe e shoqëruar me keqtrajtme dhe ushtrime të dhunës fizike ose psikike, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin shëndetit, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet burg dhe me gjobë nga 6 – 8 milionë lekë.

- Në paragrafin e katërt të këtij neni parashikohet se kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga 8-10 milionë lekë.

- Në rast se kjo vepër kryhet duke shfrytëzuar funksionin shtetëror ose shërbimin publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me $\frac{1}{4}$ e dënimit të dhënë.

Në nenin 7 të Kodit tonë Penal është parashikuar se dhe për shtetasit e huaj që kryejnë vepra penale në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastin konkret përfshihen edhe veprat penale të sipërcituara, përgjigjen në bazë të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, në zbatim të shkronjës (d) të nenit 7 të Kodit Penal, ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasit e huaj që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kryejnë në dëm të shtetit shqiptar ose të shtetasve shqiptarë krimet, si: organizim prostitucioni, trafikim të jashtëligjshëm të njerëzve, fëmijëve dhe grave.

26. Dispozitat ligjore, të cilat parashikojnë konfiskimin e mjeteve të përdorura për të kryer apo lehtësuar kryerjen e krimeve, apo të ardhurat e përfituara nga këto krime janë nenet 30 pika 2 (30/2) dhe 36 të Kodit Penal, ndërsa procedura që duhet të ndiqet në këto raste është parashikuar në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale.

Dispozitat ligjore, që përcaktojnë mbylljen e ambienteve dhe heqjen përkohësisht ose definitivisht të së drejtës për ushtrimin e aktivitetit, i cili është përdorur për kryerjen e veprave penale janë neni 274 (objekti i sekuestros preventive) i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 39 (Heqja e së drejtës të ushtrimit të veprimtarisë apo mjeshtërisë) i Kodit Penal.

“e) mbrojtjes efektive të intimitetit dhe identitetit të tyre dhe ndalimin e shpërndarjes së informacionit që mund të çojë në identifikimin e fëmijës viktimë”.

Dispozita ligjore, që parashikon mbrojtjen e intimitetit dhe identitetit të të miturve është neni 103/4 (Ndalimi i publikimit të aktit) i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon ndalimin e publikimit të gjeneraliteteve dhe fotografive të fëmijëve. Publikimi i tyre mund të behet vetëm me vendim gjykate kur këtë gjë e kërkojnë interesat e të miturit.

VI. Mbrojtja e të drejtave të viktimave (nenet 8 dhe 9, paragrafët 3 dhe 4)

27. Reforma në sistemin e mbrojtjes shoqërore, e ndërmarrë nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara në institucionet e përkujdesjes shoqërore, duke vënë në qendër nevojat e klientit, fëmijës. Janë miratuar dhe po implemetohen standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar apo në rrezik trafikimi, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.195, datë 11.4.2007, sipas të cilave ofruesit e shërbimeve i njohin viktimat me të drejtat e tyre.

Për zbatimin e këtyre standardeve është përgatitur një draftudhëzues me udhëzime dhe formularë që kanë si synim të ndihmojnë përfituesit me njohjen e të drejtave të tyre për të përfituar shërbime edhe në rastet kur nuk bëjnë kallëzim për tutorin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" lidhur me të drejtat e viktimave të dhunës në familje dhe garancitë e tyre procedurale, MD-ja ka përgatitur fletëpalosje dhe i ka vendosur në mjediset e aksesueshme prej publikut.

Në zbatim të nenit 13 pika 2 të po këtij ligji, ku theksohet se kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:

- a) prindi ose kujdestari i të miturit;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) të afërmit;
- ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
- d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Janë vënë dispozicion të strukturave rajonale dhe vendore të policisë, strukturave të shërbimeve sociale në çdo bashki e komunë formularët dhe dokumentet:

- Kërkesëpadi "Për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes"
- Kërkesëpadi "Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes"
- Kërkesë "Për ndryshimin e një urdhri mbrojtjeje"

Në të gjitha drejtoritë e policisë në qarqe është përgatitur dhe shpërndarë Manuali i Departamentit për Hetimin e Krimeve dhe Departamentit të Rendit dhe Sigurisë Publike "Mbi procedurat standarde që duhet të zbatohet punonjësi i Policisë së Shtetit në marrjen e masave për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e kujdesin për viktimat e kësaj dhune dhe është punuar nga ana e të gjithë specialistëve dhe punonjësve të Policisë së Shtetit.

a) pranimin në proces të këndvështrimit, nevojave dhe shqetësimeve, kur interesat e tyre personale preken; (nuk ka informacion)

b) mbështetjes me shërbime sociale të fëmijëve viktimë gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit;

Për pritjen, akomodimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit apo personave në rrezik trafikimi (edhe fëmijë) është ngritur Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit si institucion i rëndësishëm në vartësi të Shërbimit Social Shtetëror (MPÇSSHB). Qendra funksionon në bazë të një bashkëpunimi të ngushtë me MB dhe IOM-in me kapacitet rreth 100 persona.

QKPVT po asiston që prej korrikut 2003 pritjen, akomodimin, rehabilitimin, referimin për integrim dhe riadhesimin (kur përfituesit janë të shtetësisë së huaj), të tre target grupe kryesore:

- Gra e vajza të trafikuar dhe në rrezik trafikimi;
- Fëmijë të trafikuar dhe në rrezik trafikimi;
- Migrantë të parregullt.

Qendra ofron:

- Asistencë psiko-sociale nga staf i kualifikuar i punonjësve socialë;
- Asistencë dhe mbështetje ligjore për personat që janë dëshmitarë në procese gjyqësore.
- Siguri dhe mbrojtje të garantuar për 24 orë të dëshmitarëve (në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe strukturat e Policisë së Shtetit);

-Asistencë mjekësore (nga personeli i Qendrës, Instituti i Shëndetit Publik, qendra spitalore "Nënë Tereza", etj.);

- Aktivitete rehabilituese e integruese;
- Referim për integrim;
- Kthim dhe bashkim me familjen;
- Ndjekje të viktimave dhe pasi largohen nga Qendra (kur është e mundur);
- Ushqim, veshje, strehim të përkohshëm (mbulimin e të gjitha nevojave emergjente që paraqiten).

Qendra me aktivitetin e saj ka dhënë impakt për parandalimin e trafikut të paligjshëm, mbrojtjen, bashkimin me familjen dhe në rastet e kur është e mundur, edhe parapërgatitjen e viktimave për integrimin e tyre në jetën shoqërore.

c) mbrojtjes efektive të intimitetit dhe identitetit të tyre dhe ndalimin e shpërndarjes së informacionit që mund të çojë në identifikimin e fëmijës viktimë;

Për të miturit që trajtohen në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, siguria dhe mirëqenia e viktimës përbën shqetësimin më kryesor.

Standardet e miratuara për shërbimet e ofruara për qendra parashikojnë detyrimin që ofruesi i shërbimit të vërë në dispozicion të Agjencisë së Zbatimit të Ligjit (AZL) (organeve të policisë dhe prokurorisë) informacionin e kërkuar në lidhje me rastin.

Aksesi në të dhënat për personat e strehuar në qendër sigurohet në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi:

- ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

- ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”;

- vendimin e Këshillit të Ministrave nr.195, datë 11.04.2007 “Për standardet shërbimeve për VET” etj.

d) mbrojtjes nga kërcënimet dhe hakmarrja;

Në këtë pikë hyjnë dispozitat e ligjit “Për mbrojtjen e dëshmitarëve”, për të cilën mund të përgjigjet MB-ja.

“29. Neni 49 i Kodit të Procedurës Penale “Mbrojtësi i caktuar” në pikën 2 të tij theksohet se: Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme.

Po kështu në pikën 7 të këtij neni thuhet se kur i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme, shpenzimet e bëra për mbrojtjen paguhen nga shteti (kuptohet edhe për rastet e fëmijëve).

Gjithashtu, në nenin 50, shkronja “e” të Kodit Penal, është përcaktuar si rrethanë rënduese vepra penale e kryer kundër fëmijëve.

31. Sipas ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, konkretisht nenit 6/f, si dhe nenit nr.7 pika 2/a, 3/a, 4/a, 4/c, ku sanksionohen shprehimisht përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për trajnimin e personave që do të merren me viktimat e dhunës në familje.

Në zbatim të këtij detyrimi, si dhe në respektim të strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që prej muajit korrik 2007, në Drejtoritë e Përgjithshme të Policisë është ngritur sektori i mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje ndërsa në nivel vendor “seksione” respektive. Këto struktura kanë për detyrë mbrojtjen e të miturve nga çdo formë dhune, shfrytëzimi apo keqtrajtimi, si dhe parandalimin dhe goditjen e dhunës në ambientet familjare. Në vitin 2008 strukturave policore në nivel qendror dhe vendor iu shtua në organigramë edhe një psikolog i cili do të marrë pjesë në çdo rast kur policia trajton të mitur, duke filluar që nga shoqërimi i të miturit, marrja në pyetje, ndalimi etj. Departamenti për Trajnimin Policor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka miratuar zhvillimin e një cikli trajnimesh me struktura të policisë vendore lidhur me rolin e policisë në trajtimin e të miturve dhe dhunës në familje.

32. Në nenin 10 të ligjit 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, pika 1,2 dhe 3, sanksionohen masat e mbrojtjes që ndërmerren për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, si:

1. Mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, do të sigurohet me këto mënyra:

a) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/en (dhunuesin/en) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj paditësit/es (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

b) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/en (dhunuesin/en) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

c) duke larguar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;

ç) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

d) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm ose të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimja, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

dh) duke vendosur menjëherë viktimën/at dhe të miturit në strehime të përkohshme, duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;

e) duke kufizuar ose duke ndaluar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

ë) duke i ndaluar të paditurit/ës (dhunuesit/es) hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;

f) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbarues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin/ën (dhunuesin/en) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;

g) duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të konfiskojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij;

gj) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktimja dhe dhunuesi/ja ose ndonjë pjesë të saj;

h) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të paguajë qiranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;

i) për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;

j) duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore të paditurit/ës (dhunuesit/es);

k) duke vendosur dhe duke urdhëruar sipas rastit (në kompetencë të gjykatës) ndërhyrjen e shërbimeve sociale, publike apo private të vendbanimit ose pranë organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje;

l) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët, për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën, gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;

ll) duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;

m) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të marrë pjesë në programe rehabilitimi; nëse i/e padituri/a (dhunuesi/ja) urdhërohet të shkojë në një program rehabilitimi, përgjegjësve të programit u kërkohet të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi e ndjek apo merr pjesë në të. Nëse i/e padituri/a (dhunuesi/ja) nuk merr pjesë, atëherë, me kërkesë të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, gjykata e thërret këtë përpara saj dhe zbaton dispozitat përkatëse të Kodit Penal, për pengimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës.

2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendimin e gjykatës, mund të parashikohen disa nga masat e parashikuara në shkronjat “a” deri në “g” të këtij neni.

34. Në pikën 27 ka një informacion mbi Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, që është një institucion i rëndësishëm në vartësi të Shërbimit Social Shtetëror (MPCSSHB), dhe që bashkëpunon ngushtë me MB-në dhe IOM-in, me kapacitet rreth 100 persona. Ky institucion zbaton politikat dhe programet shtetërore për mbrojtje sociale dhe riintegrim të fëmijëve viktimë të akteve të parashikuara nga ky protokoll.

36. Në Shqipëri nuk bëhen dallime në trajtimin e fëmijëve viktimë të këtyre krimeve, pavarësisht shtetësisë së tyre, nëse këto krime kryhen në territorin e Shqipërisë. Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur raste të tilla.

VII. Ndhima ndërkombëtare dhe bashkëpunimi (neni 10)

38. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, janë nënshkruar një sërë marrëveshesh dhe protokolle në aspektin e ndihmës së ndërsjellë juridike dhe bashkëpunimit policor.

Një instrument i rëndësishëm në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve ka qenë edhe miratimi i marrëveshjes dypalëshe me Greqinë “Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit” e nënshkruar në Tiranë, në shkurt të vitit 2006. Me ratifikimin në dhjetor 2008 nga pala greke, i është dhënë tashmë udhë fillimit nga puna për zbatimin sa më rigoroz të saj. Kjo marrëveshje është e para e këtij lloji në rajon dhe është një dokument mjaft i rëndësishëm në aspektin e parandalimit, mbrojtjes dhe integritetit të fëmijëve viktimë të trafikimit në Greqi, si një nga vendet kryesore të destinacionit për shfrytëzimin e fëmijëve për punë dhe shërbime të tjera të jashtëligjshme. Gjatë muajit gusht-shtator, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje janë trajtuar edhe rastet e para të referuara nga pala greke.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit rajonal në çështjet e luftës dhe parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore, Koordinatori Kombëtar i mbështetur nga njësi antitrafik, ka organizuar dhe bërë takime ndërkufitare me Maqedoninë dhe Kosovën. Në këto takime synohej konkretizimi i këtij bashkëpunimi nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dhe protokolleve dypalëshe për bashkëpunim policor dhe ndërkufitar në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Në muajin shtator 2007, u nënshkrua protokoll i shtesë “Për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore përmes kufijve shtetërorë dhe për intensifikimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit të viktimave, si dhe personave të dyshuara si viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore” me Ministrinë e Brendshme të Maqedonisë.

Në tetor 2007, u zhvillua një takim me autoritetet kosovare të Policisë Kufitare, sektorit të trafiqeve të paligjshme, ku u diskutua mbi përmirësimin e metodave të bashkëpunimit midis dy vendeve, si dhe draftprotokollin me Kosovën “Për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore përmes kufijve shtetërorë dhe për intensifikimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit të viktimave, si dhe personave të dyshuar si viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore”.

Që prej vitit 2007, në kuadër të projektit të ICMPD-së “Për krijimin e mekanizmave transnacionalë të referimit në Evropën Juglindore” Shqipëria ka organizuar trajnime për njohjen e procedurave standarde operative të referimit kombëtar dhe transnacional të viktimave të trafikimit, me target aktorët kryesorë për zbatimin e procedurave, përkatësisht punonjësit socialë të zyrave rajonale, punonjësit e policisë kufitare dhe të migracionit etj. Këto trajnime janë organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe me mbështetjen e ICMPD-së.

Dita kombëtare antitrafik-18 tetor

Në kuadër të Ditës Evropiane kundër Trafikimit në Njerëz, tashmë është bërë traditë që edhe Shqipëria, si të gjitha vendet e tjera evropiane, organizon aktivitete të ndryshme për të ndërgjegjësuar qytetarët në lidhje me fenomenin e trafikimit në njerëz.

Në ditën Kombëtare Antitrafik, më 18 tetor 2008, Koordinatori Kombëtar Antitrafik dhe njësi antitrafik organizuan një aktivitet publik me moton: Trafikimi është një rrugë pa kthim. Thuaj jo trafikimit. Ky aktivitet u transmetua gjerësisht nga kanalet televizive më të mëdha të vendit. Në këtë aktivitet morën pjesë shumë aktorë antitrafik dhe studentë.

Gjithashtu, më datë 20 tetor 2009, CIES (Qendra e Informimit dhe Edukimit për Zhvillim) në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Shqipëria, Italia dhe Greqia kundër trafikimit të femrave dhe fëmijëve” organizoi ceremoninë e inaugurimit të Teatrit Interaktiv “Unë udhëtoj ... i vetëm” i pari i këtij lloji në vendet e rajonit.

Linja telefonike pa pagesë 0 800 1212

Linja telefonike pa pagesë 0 800 1212 e vënë në funksion në nëntor të vitit 2006, funksion plotësisht, duke shërbyer jo vetëm si një mjet informues publik mbi migracionin e rregullt, por edhe si mjet parandalues për rastet e trafikimit në vend.

Promovimi për zbatimin e Kodit të Sjelljes në Turizëm

Shqipëria nuk regjistron asnjë rast të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm, por megjithatë tashmë në Shqipëri janë ngritur të gjithë mekanizmat e nevojshëm për identifikimin e këtyre rasteve dhe referimin e tyre. Në vitin 2007, Ministria e Brendshme ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe prezencën e OSBE-së në Shqipëri “Për promovimin dhe zbatimin e kodit të sjelljes për parandalimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm”. Pas nënshkrimit të këtij dokumenti, 22 operatorë turistikë (agjenci turistike dhe hotele), nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për implementimin e Kodit në aktivitetet e tyre. Ministria e Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka iniciuar ngritjen e një grupi ndërministror pune, i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes. Grupi do të përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, MPCSSH dhe Shoqatës Shqiptare të Turizmit.

Operatori nënshkruar ka detyrimin të vendosë një politikë etike të kompanisë lidhur me shfrytëzimin seksual të fëmijëve për qëllime përfitimi, të trajtojë personelin turistik, të prezantojë një pikë në kontrata me furnitorët, ku bashkërisht dënohet shfrytëzimi seksual i fëmijëve për qëllime përfitimi, t’i siguroj informacion udhëtarëve nëpërmjet katalogëve, broshurave, filmave në udhëtim etj. në lidhje me problemin, të siguroj informacion për personat e kontaktit mbi Kodin e Sjelljes, si dhe të raportoj çdo vit mbi zbatimin e Kodit të Sjelljes për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në turizëm.

Një mesazh televiziv i Koordinatorit Kombëtar Antitrafik mbi turizmin seksual me fëmijë u transmetua në kanalet televizive kryesore në vend i cili vazhdon të ritransmetohet në sezonet e pikut turistik dimëror dhe veror. Spoti synon të informojë publikun e gjerë për dispozitën ligjore se “Shfrytëzimi seksual i të miturve” përbën krim dhe ndëshkohet. Gjithashtu, ai synon të sensibilizojë hotelierët si personat e parë me ndikim, si dhe të gjithë ata që quhen “Key persons”.

Stendat në pikat kufitare

Me ndihmën e OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në pjesën më të madhe të pikave të kalimit kufitar dhe ato doganore janë vendosur stenda dhe postera, të cilat promovojnë zbatimin e Kodit të Sjelljes dhe parandalimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

39. Janë ndërmarrë disa nisma dhe projekte të përbashkëta me vende të rajonit (kryesisht ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe me Italinë) në bashkëpunim me SHBA-në, të cilat kanë si synim luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore, me një fokus të veçantë në luftën kundër trafikut të fëmijëve.

40. Bashkëpunimi me UNICEF-in, që është shtjelluar në pikat më lart, është një shembull i mirë i bashkëpunimit.

41. Është miratuar Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale 2007-2013, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.80, datë 28.1.2008, e cila mbështetet në prioritetet e Programit të Qeverisë për politikat sociale, reduktimin e varfërisë, përmirësimin e cilësisë së jetës së grupeve në nevojë dhe fuqizimin e tyre për t’u përfshirë në zhvillimet komunitare.

Reformimi i skemës së ndihmës ekonomike dhe pagesave të tjera, do të mbështetet në identifikimin e nevojave të familjeve të varfra mbi bazën e treguesve të varfërisë absolute, mbulimin më të mirë të nevojave me fonde dhe sigurimin e një niveli dinjitoz jetese për familjet, PAK dhe

përfitues të tjerë. Në fushën e shërbimeve shoqërore, reforma ka në themel të saj ngritjen e shërbimeve në nivel komunitar, atje ku janë përfituesit dhe lindin nevojat e tyre, për të mbështetur dhe ndihmuar individin, familjen, grupin ose komunitetin që të vetëfunksionojnë, të jenë të pavarur dhe të përfshihen si të barabartë me anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Këto zhvillime do të ecin në harmoni me procesin e decentralizimit të kompetencave dhe përgjegjësi në pushtetin vendor.

Synimi i strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale është të sigurojë një politikë të qartë për reformimin e sistemit të pagesave dhe shërbimeve shoqërore, jo vetëm për grupet në nevojë, por për të gjithë shoqërinë. Objektivat kryesorë të saj për pagesat në *cash* janë: i) reduktimi i shkallës së varfërisë për frymë në 10% të popullsisë deri në 2013, në përputhje me rezultatet e LSMS (Anketa e matjes së nivelit të jetesës së familjes); ii) përmirësimi i targetimit të përfituesve në skemën e ndihmës ekonomike dhe mbulimi i nevojave të familjeve të varfra në përputhje me vijën e varfërisë absolute, sipas LSMS; iii) rritja e masës mesatare të ndihmës ekonomike; iv) kushtëzimi i shpërndarjes së NE me punë komunitare në të gjithë territorin e vendit; v) përmirësimi i administrimit të subvencionit për energjinë; vi) përmirësim i sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara; vii) përshkallëzim i pagesave për PAK në varësi të gjendjes dhe kushteve sociale.

Objektivat kryesorë për shërbimet shoqërore do të jenë: i) decentralizimi, kalimi i të gjitha shërbimeve rezidenciale brenda vitit 2007 në administrim të njësisë; ii) zgjerimi i llojshmërisë së shërbimeve komunitare dhe mbulimi i të gjitha grupeve me shërbime bazë në të gjitha rrethet e vendit; iii) shtrirja e shërbime komunitare deri në vitin 2013 edhe në bashkitë që aktualisht nuk kanë shërbime të tilla; iv) pilotimi i shërbimit të kujdestarisë 2008-2010 në dy bashki dhe deri në vitin 2013, shtrirja e këtij shërbimi edhe në njësit e tjera vendore në përputhje me nevojat dhe mundësitë e buxhetit; v) deinstitutionalizimi, konsolidimi i modelit të shërbimeve “shtëpi-familje” për fëmijët dhe PAK, zgjerimi i këtyre shërbimeve edhe për grupet të tjera sociale (të rinjtë, të moshuarit); vi) implementimi i standardeve të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për fëmijët, PAK, të moshuarit; vii) inspektimi dy herë në vit i të gjitha shërbimeve të përkujdesit rezidencial dhe ditor që ofrohen nga operatorët publikë dhe privatë; viii) licencimi i ofruesve të rinj dhe rilicencimi periodik i të gjitha OJF-ve që ofrojnë shërbime të përkujdesit.

Është hartuar dhe po implementohet legjislacioni ri i mbrojtjes sociale, ligji dhe akte nënligjore në zbatim të tij.

1. Për ndihmën ekonomike: evidentimi i numrit të familjeve të varfra në skemën e ndihmës ekonomike (NE) me nën 2\$ në ditë për person në vitin 2008 u krye në përputhje me hartën e varfërisë, që mbështetet në LSMS 2002, 2005. Të dhënat u përfshinë në programimin e NE-së për vitin 2009.

Për vitin 2009 evidentimi i numrit të familjeve të varfra në skemën e NE-së u mbështet në analizën e të dhënave të LSMS 2008 dhe analizën komplekse me gjetjet e LSMS 2002 dhe 2005. U rishikua harta e shpërndarjes së varfërisë në vend, e cila do të shërbejë për përcaktimin e numrit të familjeve dhe fondeve për NE-në për vitin 2010.

Është hartuar një projektligji i ri që përmirëson ligjin nr.9355 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore”, i cili garanton lehtësi për përfshirjen në skemën e NE-së:

1. të jetimëve të cilët nuk janë në institucione;
2. të viktimave të trafikimit pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror;
3. të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

Sipas këtij projektligji përjashtohen nga llogaritja e të ardhurave, për efekt të përfitimit të NE familjet në nevojë që kanë:

- a) si kryefamiljarë njërin nga fëmijët nën moshë pune, për arsye të vdekjes së të dy prindërve;

b) si kryefamiljarë njërin nga fëmijët nën moshë pune, kur njëri prej prindërve është dënuar për vepra penale ose kundërvajtje penale me vendim të formës së prerë të gjykatës ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton;

c) si kryefamiljarë njërin nga fëmijët nën moshë pune, kur njërit prind i është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton;

d) si kryefamiljarë nënën, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, si dhe kur anëtarët e familjes së tij janë, mbi punë dhe nën moshë pune, të cilët nuk përfitojnë pension;

e) si kryefamiljar një pjesëtar të familjes që është mbi moshë pune dhe që nuk përfiton pension, si dhe kur anëtarët e familjes së tij janë mbi punë dhe nën moshë pune, të cilët nuk përfitojnë pension.

VIII. Dispozita të tjera ligjore (neni 11)

42. Nuk ka legjislacion kombëtar apo ndërkombëtar, në fuqi në vend, që të realizojë më mirë interesat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre për sa i përket shitjes, prostitucionin apo pornografinë e fëmijëve.

Shqipëria është palë në të gjitha instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Në veçanti Konventa për të drejtat e fëmijëve i ka paraprirë përmirësimeve të legjislacionit të brendshëm. Një influencë jashtëzakonisht të madhe luan edhe procesi integruar në BE, dhe ai i sapo përfunduar në NATO, të cilat kanë bërë që Shqipëria të përafrojë legjislacionin dhe praktikën e saj me standardet më të larta evropiane dhe botërore lidhur me realizimin e të drejtave të njeriut, në përgjithësi, dhe ato të fëmijëve, në veçanti.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar luftës kundër trafikëve, me synimin kryesor luftën kundër trafikut të qenieve të gjalla, si një nga kushtet themelore të BE-së për përfshirjen e Shqipërisë në zonën e lëvizjes së lirë.

VENDIM

Nr.422, datë 26.5.2010

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “LLËNGË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Llëngë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “I3F1” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Llëngë”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.428, datë 9.6.2010

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET APO
TRANSFORMOHET, DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008 me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË PASURISË SHTETËRORE

1. Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha ndërmarrjet apo objektet e veçuara, mjetet kryesore dhe mjetet e xhiros së ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe institucioneve, me kapital tërësisht shtetëror, për të cilat është dhënë miratimi i ministrit përgjegjës për privatizimin, për fillimin e procedurave të privatizimit apo të transformimit në shoqëri tregtare.

2. Institucionet qendrore dhe organet e njësisë të qeverisjes vendore, për pasuritë e ndërmarrjeve apo të institucioneve, që kanë në varësi administrative a në pronësi, e dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Ministri përgjegjës për privatizimin nxjerr urdhrin e miratimit për privatizim, pas mendimeve të përmendura më sipër.

Në rast se ministria përgjegjëse për privatizimin e pronës u kërkon institucioneve qendrore apo organeve të njësisë të qeverisjes vendore kërkesën për prononcim privatizimi për pasuritë e ndërmarrjeve apo të institucioneve, të cilat i kanë në varësi administrative, këto institucione janë të detyruara, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e kërkesës, të dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive. Në rast se ky afat tejkalohet, atëherë ministria përgjegjëse për privatizimin e pronës shtetërore ngre një komision, të përbërë nga tre anëtarë, i cili verifikon faktikisht objektin. Nëse pas këtij verifikimi rezulton se objekti është i braktisur dhe nuk përdoret nga institucioni që e ka në administrim apo në pronësi, atëherë ministri përgjegjës për privatizimin e pronës shtetërore jep miratimin për privatizim të këtyre objekteve, duke e konsideruar të dhënë pëlqimin nga institucioni administrues për përfshirjen e tyre në privatizim dhe i kërkon institucionit administrues caktimin e një përfaqësuesi në komisionin e vlerësimit të pronës.

Nëse institucionet qendrore dhe organet e njësisë të qeverisjes vendore shprehen për mosprivatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo të institucioneve, që i kanë në varësi administrative, ato duhet ta argumentojnë qartë këtë fakt.

3. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore, në zbatim të këtij vendimi, ngrihet nga ministri përgjegjës për privatizimin.

Ky komision kryesohet nga kryetari i degës së shoqërive publike, në prefekturën ku ndodhet objekti, dhe në përbërje ka:

- ekspertin vlerësues, të licencuar;
- përfaqësuesin e ndërmarrjes apo të institucionit, në administrim të të cilit ndodhet objekti.

Sipas nevojave të procesit të vlerësimit të objektit, nëse është e nevojshme, ministri përgjegjës për privatizimin urdhëron që në komisionin e vlerësimit të marrë pjesë edhe eksperti kontabël apo ekspertë të tjerë të fushës përkatëse.

4. Ekspertët vlerësues në përbërje të komisionit të vlerësimit të pronës shtetërore përzgjidhen nga ministri përgjegjës për privatizimin e pronës shtetërore. Shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit (pagesa e ekspertëve etj.), bëhen nga ministria përgjegjëse për

privatizimin, përveç rasteve kur ministri përgjegjës për privatizimin e pronës shtetërore urdhëron pagesën nga institucione të tjera.

Kjo pagesë do të jetë 2 për qind e vlerës së objektit apo të grup - objekteve të vlerësuar, por jo më pak se 60 000 (gjashhtëdhjetë mijë) lekë dhe jo më shumë se 300 000 (treqind mijë) lekë.

5. Miratimi për përfshirjen në procesin e privatizimit të pasurisë së luajtshme, si elemente të veçanta, bëhet nga institucioni përkatës i varësisë administrative. Pas nxjerrjes së miratimit të privatizimit, ky institucion ngre komisionin e vlerësimit, për vlerësimin e pasurisë. Ky komision kryesohet nga përfaqësuesi përkatës i strukturës administrative dhe në përbërje ka 3 (tre) anëtarë, nga të cilët njëri duhet të jetë ekspert vlerësues i fushës përkatëse.

Shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit (pagesa e ekspertëve etj.), në rastin e mësipërm, mbuloheh nga institucioni ose ndërmarrja, në administrim të të cilit ndodhet pasuria.

6. Ngritja e komisionit të vlerësimit për objektet ndërtimore, të cilat kanë qenë në administrim të një subjekti, që nuk ekziston më, bëhet sipas urdhrit të ministrit përgjegjës për ekonominë. Komisioni i vlerësimit, në këtë rast, kryesohet nga kryetari i degës së shoqërive publike, në prefekturën ku ndodhet objekti, dhe përbëhet nga ekspertë vlerësues, të licencuar, sipas nevojave të procesit të vlerësimit.

II. VLERËSIMI I ELEMENTEVE TË PASURISË SHTETËRORE

1. Procedurat për vlerësimin e pasurisë shtetërore fillojnë me daljen e urdhrit të ministrit përgjegjës për privatizimin.

2. Vlerësimi i objekteve bëhet nga komisioni i vlerësimit, në përputhje me vlerën reale të tregut, në zbatim të legjislacionit në fuqi, duke përdorur metodat e vlerësimit të tregut. Komisioni i vlerësimit mban përgjegjësi ligjore për vlerësimin e kryer dhe për dokumentet e hartuara e të nënshkruara prej tij (genplane, situacione, aktvlerësime etj.).

3. Me daljen e urdhrit të ministrit përgjegjës për privatizimin për ngritjen e komisionit të vlerësimit të objektit, që do të privatizohet apo që do të përfshihet në fondin e kompensimit, komisioni i vlerësimit inspekton dhe verifikon gjendjen reale të objektit dhe më pas ekspertët vlerësues të këtij komisioni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, përgatisin genplanin e ndërmarrjes apo të objekteve, që do të privatizohen, ku përcaktohen qartë sipërfaqet nën objekt dhe truall funksional, në pesë kopje origjinale. Dega e shoqërive publike përkatëse vendos një njoftim në objekt, si dhe në mjediset e organit të qeverisjes vendore (bashki, komunë), në territorin e të cilit ndodhet objekti, për efekt të ish - pronarëve të truallit, nëse ka.

4. Eksperti vlerësues brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dalja e urdhrit për privatizimin e objektit, përgatit genplanin përkatës, ku përcaktohen qartë sipërfaqja nën objekt, sipërfaqja funksionale dhe ajo e përgjithshme, në pesë kopje origjinale. Eksperti vlerësues mban përgjegjësi ligjore për hartimin e saktë të këtij genplani.

5. Komisioni i vlerësimit, pas marrjes së genplanit të përgatitur nga ekspertët, i drejton institucionit të prefektit, në territorin e të cilit ndodhet objekti, kërkesën për konfirmimin e këtij genplani.

6. Prefekti autorizon një përfaqësues, i cili nënshkruan genplanet e objekteve të kërkuara nga dega e shoqërive publike. Institucioni i prefektit konfirmon genplanin e objektit, duke nënshkruar dhe vulosur, në pesë kopje origjinale, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës së degës së shoqërive publike përkatëse dhe i përcjell degës së shoqërive publike dokumentacionin, të nënshkruar dhe të vulosur nga ana e saj.

7. Pas marrjes së genplanit, të konfirmuar nga prefektura përkatëse, dega e shoqërive publike i kërkon zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme hartën treguese të objektit, që do të privatizohet. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, i dërgon DSHP-së hartën treguese, me të dhënat përkatëse të objektit për privatizim, si dhe vërtetimin hipotekor a certifikatën e pronësisë, nëse ka. Tejkalimi i këtij afati ngarkon këtë institucion me përgjegjësi ligjore.

8. Dega e shoqërive publike, pas marrjes, nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të hartës treguese, me të dhënat përkatëse të objektit, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave konfirmimin nëse trulli, ku ndodhet objekti, ka pronarë, të njohur me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe çmimin përkatës të trullit, ku ndodhet objekti, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e çmimeve, nga kjo Agjenci dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur ky çmim nuk ekziston në hartën e çmimeve, atëherë ekspertët vlerësues përcaktojnë çmimin e shitjes së trullit të objektit, që do të privatizohet.

9. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, ia dërgon degës së shoqërive publike konfirmimin për çmimin e trullit të objektit, si dhe vendimet përkatëse të kthimit dhe kompensimit të pronave, të shoqëruara me planvendosjen e pronës, ku të jetë përcaktuar qartë kufiri i pronës, si dhe çdo informacion shtesë, nëse ka, që lidhet me vendimin përkatës të kthimit dhe kompensimit të pronave.

10. Eksperti vlerësues përcakton çmimin përkatës të trullit, ku ndodhet objekti përkatës, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e çmimeve, të hartuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur ky çmim nuk ekziston në hartën e çmimeve, atëherë ekspertët vlerësues përcaktojnë çmimin e shitjes së trullit të objektit, që do të privatizohet.

Eksperti vlerësues mban përgjegjësi ligjore për vlerësimin e trullit të bërë prej tij.

11. Afati i plotësimit të dokumentacionit të vlerësimit për ndërtesat dhe ndërtimet, linjat e prodhimit dhe të shërbimit duhet të jetë jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) ditë nga data e daljes së urdhrimit për ngritjen e komisionit të vlerësimit nga titullari, ndërsa për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit etj., afati duhet të jetë jo më shumë se 20 (njëzet) ditë, nga data e daljes së këtij urdhri.

Komisioni i vlerësimit mban përgjegjësi ligjore për respektimin e këtij afati.

12. Dokumentacioni i përgatitur nga komisioni i vlerësimit i dërgohet:

a) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për objektet ndërtimore dhe linjat e prodhimit ose të shërbimit, me shkresë përcjellëse, të nënshkruar e të vulosur nga dega e shoqërive publike përkatëse, ku përcaktohen vlera e objektit, sipërfaqja e përgjithshme, ajo nën objekt e ajo funksionale. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pasi kontrollon nëse ky dokumentacion ka kaluar në hallkat përkatëse, ia përcjell atë Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike.

b) Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike), për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, inventarin ekonomik, mjetet e xhiros etj., me shkresë përcjellëse, të nënshkruar dhe të vulosur nga dega e shoqërive publike përkatëse, kur asetet do të shiten të veçanta.

13. Vlerësimi i pasurisë së ndërmarrjeve shtetërore, që transformohen, në zbatim të urdhrimit të ministrit përgjegjës për ekonominë, bëhet në përputhje me këtë vendim.

14. Eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme harton genplanin përkatës të shoqërive aksionare dhe të shoqërive me kapital të përbashkët, të cilat janë në proces vlerësimi për privatizim, kur del i nevojshëm hartimi i një genplani të ri, i ndryshëm nga ai i përgatitur në çastin e themelimit të shoqërisë.

15. Shoqëria ia dërgon institucionit të prefektit, ku ka vendndodhjen shoqëria, kërkesën për konfirmim të genplanit, të hartuar nga ekspertët vlerësues përkatës. Institucioni i prefektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, konfirmon genplanin e shoqërisë, duke e nënshkruar dhe vulosur atë, në 5 kopje origjinale, dhe më pas ia përcjell shoqërisë.

16. Detyrimet debitore dhe kreditore të ndërmarrjeve shtetërore që privatizohen mbyllen në çastin e ndryshimit të pronësisë. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore mban përgjegjësi për rritjen e debi-kredive nga data e shpalljes së ndryshimit të pronës shtetërore.

17. Për detyrimet debitore dhe kreditore veprohet, si më poshtë vijon:

a) Kur bëhet privatizimi i të gjithë ndërmarrjes shtetërore, detyrimet debitoare dhe kreditore i kalojnë shtetit. Institucioni qendror ose organet e pushtetit vendor, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes, ngarkojnë një punonjës të sistemit financiar a një profesionist të lirë, me një kontratë të posaçme për ndjekjen e arkëtimit, deri në 30 (tridhjetë) ditë nga data e dorëzimit të objektit. Këta kanë të drejtën e shpërblimit nga 5 deri në 10 për qind të shumave të arkëtuara, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) paga bazë të përgjegjësit të financës në këshillin e qarkut ose këshillin bashkiak. Ky shpërblim reduktohet deri në zero, nëse nuk zbatohet kontrata. Kjo kontratë duhet të jetë e vlefshme deri në 3 (tre) muaj dhe pas kësaj veprohet në bazë të ligjit nr.8901, datë 23.5.2003 “Për falimentimin”.

b) Kur bëhet privatizimi i pjesëshëm i ndërmarrjes shtetërore, detyrimet debitoare dhe kreditore të ndërmarrjes i kalojnë për ndjekje administratës për pjesën që mbetet shtetërore.

III. PROCEDURA E SHITJES SË PRONËS SHTETËRORE

1. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, e pranon dosjen e vlerësimit për objektin që do të privatizohet, nëse për këtë objekt ka dokumentacion të rregullt, i cili u ka kaluar strukturave përkatëse, të përcaktuara në këtë vendim. Në rast të kundërt, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kërkon plotësimin e dokumentacionit.

2. Shitja e objektit bëhet, si më poshtë vijon:

a) Për rastet kur konfirmohet se objekti ndodhet në truallin e subjekteve të shpronësuara, shitja bëhet pa ankand dhe subjektet e shpronësuara të truallit, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, kanë të drejtën e parablerjes së objektit me vlerën fillestare.

Në këtë rast, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, afishon një njoftim në mjediset e saj, për një afat 20–ditor, vetëm për pronarët e truallit, ndërsa dega e shoqërive publike në mjediset e saj dhe në objekt.

Dokumentacioni për dhënien e së drejtës së parablerjes për objektin, që privatizohet, për çdo rast, shqyrtohet e konfirmohet me procesverbal të veçantë dhe miratohet nga komisioni i ngritur nga drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes të Pronave Publike, në Ministrinë e Financave.

b) Në rastet kur subjektet e shpronësuara të truallit, pas afishimit të njoftimit sipas shkronjës “a” të kësaj pike, nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, nuk kanë paraqitur dokumentet e pronësisë, deri në afatin e përcaktuar në njoftim, bëhet një njoftim i dytë, në dy gazeta me qarkullim kombëtar, duke i përcaktuar një afat të ri, prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga data e njoftimit të parë. Nëse edhe në këtë afat të dytë pronari nuk paraqitet, atëherë kryhet shitja e objektit dhe e truallit me ankand, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim. Vlera e truallit, e përcaktuar sipas hartës së vlerës, i shkon drejtpërdrejt pronarit për kompensim financiar.

c) Në rastet kur konfirmohet se objekti, që privatizohet, nuk ndodhet në truallin e subjekteve të shpronësuara, si dhe për rastet kur AKKP-ja nuk është në gjendje të konfirmojë pronësinë e truallit për objektin që privatizohet, ai i nënshtrohet ankandit, sipas procedurave të këtij vendimi. Kur në datën e zhvillimit të ankandit paraqitet subjekti i shpronësuar i truallit me dokumentacionin ligjor, që vërteton pronësinë e truallit të objektit, atëherë subjekti i shpronësuar gëzon të drejtën e parablerjes, me vlerën fillestare të objektit. Edhe për këtë rast do të veprohet sipas shkronjës “a” të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi, por vetëm pasi të jetë konfirmuar dokumentacioni i pronësisë i depozituar nga ish- pronarët e truallit pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Në rastet kur gjatë periudhës së publikimit të objektit para datës së zhvillimit të ankandit, depozitohet në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kërkesa e pronarit të truallit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së truallit, atëherë do të veprohet sipas shkronjës “a” të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi, por vetëm pasi të jetë konfirmuar dokumentacioni i pronësisë, i depozituar nga ish- pronarët e truallit pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

3. Në ankandet për shitjen e pasurive të shoqërive në likuidim e sipër nuk zbatohet e drejta e parablerjes për ish-pronarët e truallit. Ata marrin pjesë në ankand si të gjithë të tjerët. Në rastet e shpalljes fitues, ish-pronarëve u zbritet vlera e truallit, e njohur apo e kthyer, me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e vlerësuar me çmimet e hartës së vlerës së truallit, miratuar nga Këshilli i Ministrave.

4. Procedurat e publikimit fillojnë pasi të jenë dorëzuar, në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dokumentet e vlerësimit të objektit.

5. Vlera e fillimit të ankandit është VAM-i, i përcaktuar sipas kreut II të këtij vendimi, (mjete kryesore + mjete xhiroje + vlera e truallit). Ankandi zhvillohet vetëm për vlerën e mjeteve kryesore + vlerën e truallit dhe vlera e mjeteve të xhiros shtohet sipas inventarit fizik, në çastin e dorëzimit të objektit. Shitja e pasurisë së luajtshme bëhet vetëm me ankand sipas procedurave të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, pasi ka pranuar dokumentet e vlerësimit të objektit, ndërmerr hapat përkatës për publikimin e tij për privatizim, si më poshtë vijon:

a) Periudha e botimit zgjat 21 (njëzet e një) ditë nga data e botimit të parë dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Dita e parë e botimit është data e përcaktuar në njoftimin që Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dërgon për botim. Brenda këtij afati, ky njoftim botohet edhe në një gazetë, me qarkullim kombëtar.

b) Botimin e listës së objekteve, që do të privatizohen, dhe shpalljen e kësaj liste në faqen e internetit të Ministrisë së Financave, me të dhënat për çdo objekt.

c) Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, fillimisht, afishon njoftimin në mjediset e saj, për zhvillimin e ankandit të tyre, ndërsa dega e shoqërive publike, në prefekturë, e afishon njoftimin në mjediset e veta, në ndërmarrjen në administrim të së cilës është objekti, në objekt, si dhe në mjediset e organit të qeverisjes vendore (bashki, komunë), në territorin e të cilit ndodhet objekti, që privatizohet, sipas të dhënave (afishe) të dërguara nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Degët e shoqërive publike, në prefekturë, dërgojnë zyrtarisht procesverbalin për vendosjen e afisheve, brenda afatit të botimit në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike.

7. Njoftimi për botim përmban të dhënat e mëposhtme:

a) Vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;

b) Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit, që privatizohet;

c) Vlerën fillestare të ankandit;

ç) Sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nën objekt;

d) Emrin dhe mbiemrin e pronarit të truallit, nëse ka etj.

8. Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kanë të drejtë të studiojnë dokumentacionin e vlerësimit, që ndodhet i depozituar në këtë drejtori, si dhe të njihen me gjendjen fizike të objektit.

9. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, harton dhe arkivon një procesverbal, i cili përmban:

a) kopjen e buletinit;

b) kopjen e afishimit në gazetë;

c) datat e botimit të njoftimeve;

ç) kopjen e njoftimit me afishe.

10. Pjesëmarrësit në ankand duhet t'i paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar, komisionit të ankandit këto dokumente:

a) Kërkesën me shkrim për blerjen e objektit të regjistruar në protokollin e Ministrisë së Financave;

b) Garancinë bankare (apo mandatpagesën), që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave.

11. Subjekti i shpronësuar i truallit, së bashku me kërkesën për blerjen e ndërmarrjes ose të objektit, që shtrihet në truallin, ish-pronë të tij, duhet të paraqesë në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me shkrim për blerjen e objektit të regjistruar në protokollin e Ministrisë së Financave;

b) Garancinë bankare (apo mandatpagesën), që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin, për llogari të Ministrisë së Financave, detyrimisht, brenda afatit të pranimit të kërkesave;

c) Vendimin përkatës të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës;

ç) Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.

12. Kur sipërfaqja e tokës, pronë e subjektit të shpronësuar, shtrihet në mbi 70 % të sipërfaqes së truallit nën objekt, për objektin, që privatizohet, e drejta e parablerjes shtrihet në të gjithë objektin, nëse pjesa tjetër nuk ka pronarë. Në të kundërt, pavarësisht se njëri nga ish-pronarët apo bashkëpronarët e plotësojnë kushtin e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike dhe pjesa tjetër ka pronarë truall të identifikuar, objekti privatizohet vetëm në bashkëpronësi, me marrëveshje të dokumentuar.

Nëse nuk arrihet marrëveshje e dokumentuar ndërmjet bashkëpronarëve brenda një afati 30 - ditor të publikimit me afishe, objekti u nënshtrohet procedurave të ankandit dhe ish-pronarët kompensohen financiarisht sipas vlerës së truallit të vlerësuar sipas hartës së vlerës.

Në rastet e shpalljes fitues të ankandit, që zhvillohet për shitjen e objektit të njërit prej ish-pronarëve të truallit, në pagesën e vlerës së truallit zbritet vlera e truallit, që i përket pjesës së tij, e njohur me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, e vlerësuar me çmimet e hartës së vlerës së truallit.

Për rastet kur, për objektin që privatizohet, ka një pronar apo disa bashkëpronarë, të cilët kanë një marrëveshje të dokumentuar dhe gëzojnë të drejtën e parablerjes, por një pjesë e truallit, sipas genplanit të privatizimit, nuk bie në pronën e ish-pronarëve të konfirmuar shtetërorë, veprohet, si më poshtë vijon:

Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike ua ofron për blerje bashkëpronarëve, që gëzojnë të drejtën e parablerjes së objekteve.

Në rast se ish-pronarët shprehen me shkrim se nuk janë dakord ta blejnë këtë sipërfaqe truall, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike i dërgon një shkresë, të shoqëruar me kopje të genplanit, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për përdorimin e kësaj sipërfaqeje për fond kompensimi për ish-pronarët, duke vënë në dijeni edhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

13. Në rastet kur objektit i është ulur vlera e fillimit të ankandit, subjekti i shpronësuar, për të ushtruar të drejtën e parablerjes, duhet të bëjë pagesën e plotë, sipas vlerës fillestare dhe jo sipas vlerës së ulur.

14. Kur për objektet e shpallura për shitje, sipas procedurave të këtij vendimi, nuk paraqitet asnjë kërkesë për blerjen e tyre, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, cakton një +VAM tjetër, me të ulët se VAM-i fillestar, për privatizimin e objektit.

15. Ulja e VAM-it të objekteve bëhet sipas këtij kategorizimi:

a) Për ndërmarrjet ose objektet, deri në 30%;

b) Për makineritë, pajisjet, inventarin ekonomik, mjetet e transportit, mjetet e xhiros, deri 50%. Në këto raste, objekti u nënshtrohet edhe një herë të gjitha procedurave të shitjes, të parashikuara në këtë vendim.

16. Për rastet kur mbetet vetëm një blerës, si në publikimin me vlerë fillestare, ashtu edhe për rastin kur objekti është i publikuar me ulje VAM-i, bëhet një njoftim i ri, në një gazetë kombëtare, për një periudhë 10-ditore, si dhe vendoset një njoftim me afishe pranë mjediseve, ku do të kryhen procedurat e zhvillimit të ankandit. Pas këtij publikimi, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, realizon shitjen e objektit.

17. Procedurat për rastet e parashikuara në pikat 2, 6, 12 e 16 të këtij vendimi, fillojnë me miratimin e drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave. Çdo element shtesë është pjesë e botimit.

18. Për rastet kur nuk është realizuar shitja, veprohet, si më poshtë vijon:

a) Objektet ndërtimore, të cilat i kanë kaluar të gjitha fazat e shitjes, kthehen në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila ia dërgon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për t'i kaluar në fond kompensimi fizik për subjektet e shpronësuara.

b) Makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros, inventar ekonomik, të cilat nuk janë shitur, pasi janë zbatuar fazat e shitjes, sipas VAM-it fillestar dhe VAM-it të ulur, kthehen nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, në degën e shoqërive publike përkatëse.

19. Komisioni i ankandit kryesohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- Përfaqësuesin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

- Përfaqësuesin e organit që ka në pronësi, ruajtje apo në varësi administrative objektin.

Anëtarët e komisionit të ankandit duhet të pajisen me autorizimin përkatës dhe pjesëmarrja e tyre, në datën dhe orën e caktuar për ankand, është e detyrueshme.

Në rast se në ditën e njoftuar për zhvillimin e ankandit nuk paraqitet njëri nga anëtarët e komisionit, anëtarët e tjerë të pranishëm të komisionit administrojnë kërkesat e paraqitura për blerje dhe komisioni njofton një ditë tjetër për zhvillimin e ankandit, por jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë nga data e parë e njoftuar për ankand. Nëse edhe në njoftimin e dytë nuk paraqitet njëri nga anëtarët e komisionit të ankandit, atëherë Drejtori i Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, plotëson komisionin e ankandit me një anëtar brenda strukturës së drejtorisë dhe urdhëron zhvillimin e ankandit.

20. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

a) Regjistron dhe vërteton identitetin e pjesëmarrësve në ankand, sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose me prokurë të veçantë të përfaqësimit;

b) Prezanton anëtarët e komisionit të ankandit;

c) Deklaron vlerën fillestare të ankandit;

ç) Deklaron hapin e dhënies të ofertave për vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand;

d) Drejton marrjen e ofertave;

dh) Shpall personin e fundit, që deklaron çmimin më të lartë, si fitues i ankandit;

e) Siguron që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

21. Komisioni i ankandit harton një procesverbal, i cili duhet të përmbajë:

a) Regjistrimin e identitetit të pjesëmarrësve në ankand, sipas letërnjoftimit, certifikatës së gjendjes civile ose prokurës së përfaqësimit;

b) Emrat e anëtarëve të komisionit të ankandit;

c) Deklarimin e vlerës fillestare të ankandit;

ç) Deklarimin e hapit të dhënies së ofertave për vlerën fillestare për pjesëmarrësit në ankand;

d) Shpalljen e personit të fundit, i cili deklaron çmimin më të lartë, si fitues i ankandit.

Komisioni i ankandit duhet të sigurojë, që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së fituesit.

Procesverbali i ankandit duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe pjesëmarrësit në ankand.

22. Pjesëmarrësve të tjerë në ankand, përveç fituesit, u kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar paraprakisht. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, i konfiskohet 20 % e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

23. Personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nëpërmjet ankandit, ose të drejtën e parablerjes pajiset nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, me autorizim për kalim pronësie, ku përcaktohen qartë detyrimet e blerësit.

24. Blerësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, është i detyruar të bëjë pagesën, vetëm me lekë, për pjesën e mbetur, sipas çmimit të arritur në ankand, për objektin dhe truallin.

Ish-pronarët e truallit, të cilët janë shpallur fitues me të drejtën e parablerjes për objektin apo ndërmarrjen që privatizohet, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të autorizimit për kalim pronësie nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, janë të detyruar të bëjnë pagesën e vlerës së mbetur të objektit, me letra me vlerë dhe bono privatizimi.

25. Të ardhurat e realizuara nga shitja ndahen, si më poshtë vijon:

a) Për shitjen e objektit (mjete kryesore e mjete xhiroje etj.):

i) 5% e vlerës së shitjes i kalon Ministrisë së Financave;

ii) 30 % e vlerës së shitjes i kalon Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

iii) 65% e vlerës së shitjes i kalon Buxhetit të Shtetit.

b) Për shitjen e truallit, 100 % e vlerës së shitjes kalon për efekt të fondit të kompensimit financiar, për subjektet e shpronësuara, përveç rasteve, kur është i identifikuar ish-pronari i truallit. Në këto raste, do të veprohet sipas shkronjës "b" të pikës 2 të kreut III të këtij vendimi.

26. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nuk paguan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pjesën e mbetur të çmimit të arritur në ankand, si fitues ankandi, humbet të drejtën e blerjes, si dhe të marrjes pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti.

Pagesa 20%, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand, nuk i kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit nga e para, sipas këtij vendimi.

Nëse ish-pronari i truallit, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nuk paguan brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të autorizimit pjesën e mbetur të çmimit, atëherë pagesa 20%, e ngurtësuar për pjesëmarrje në blerje, i konfiskohet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit nga e para, sipas pikës 2 të kreut III të këtij vendimi.

27. Pas pagesës së vlerës së plotë të objektit (objektit bashkë me truallin për shitjet me ankand), Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike dhe drejtori i ndërmarrjes që ka në administrim objektin apo personi autorizuar prej tij janë të detyruar të nënshkruajnë kontratën e shitjes me blerësit privatë.

Dorëzimi i objektit bëhet, në mënyrë të detyrueshme, nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe përfaqësuesi i institucionit administrues (sipas komisionit të vlerësimit të ngritur), në prani të blerësit. Procesverbali i dorëzimit do të jetë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes.

28. Kontratat e nënshkruara nga përfaqësuesi i ish-Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe i degëve të saj në rrethe, për objektet apo ndërmarrjet e privatizuara në vite, me përfaqësuesin e ndërmarrjes dhe blerësit, por jo sipas mënyrës së kërkuar nga ligji (para noterit), për rastet kur aktualisht nuk ekziston ndërmarrja, bëhen nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe blerësi, kur dokumentacioni, që ndodhet në arkivat e kësaj drejtorie, është i rregullt.

Kur ekziston ndërmarrja, bëhet nga drejtori i ndërmarrjes dhe blerësi, para noterit.

29. Në rastet kur nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe janë kryer të gjitha procedurat ligjore, për privatizimin e objekteve apo të ndërmarrjeve shtetërore, sipas dokumentacionit të plotë, që ndodhet në arkivin e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike (dosja e vlerësimit, ankandi apo e drejta e parablerjes, autorizimi për kalim pronësie, pagesa e plotë etj.), por që, për arsye të ndryshme, nuk ka qenë e mundur të lidhet kontrata e shitjes dhe kur, aktualisht, nuk ekziston ndërmarrja, që e ka pasur në administrim objektin, Drejtorja e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kryetari i degës së shoqërive publike, në prefekturën përkatëse, dhe blerësi nënshkruajnë kontratën e shitjes, sipas legjislacionit në fuqi.

30. Nuk lejohen dhënia me qira dhe kalimi kapital i objekteve, që janë publikuar për shitje.

31. Dokumentacioni i vlerësimit të objekteve ndërtimore, të cilat nuk janë shitur edhe pasi janë zbatuar të gjitha fazat e shitjes, sipas këtij vendimi, përcillet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila ia dërgon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për t'u përdorur si fond i kompensimit fizik. Për makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros, inventar ekonomik, të cilat nuk janë shitur edhe pasi janë zbatuar të gjitha fazat e shitjes, veprohet sipas vendimit nr.70, datë 11.3.1985 të Këshillit të Ministrave "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave, materiale e monetare", të ndryshuar.

32. Për shitjet e bëra nga Drejtorja e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, njoftohet, me një evidencë statistikore, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datën 20, të çdo muaji.

33. Pasuritë shtetërore, të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteoze, mbi 500 (pesëqind) m², i shiten, në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtorja e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kontraktuesit, në rast se vlera e investimit të kryer prej tij është mbi 150 % e vlerës së truallit, si dhe kur subjekti nuk ka detyrime ndaj shtetit. Përcaktimi i vlerës së investimeve bëhet nga ekspertë vlerësues të licencuar dhe ekspertë kontabël të autorizuar, të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë, i cili urdhëron fillimin e procedurës së mësipërme.

34. Drejtorja e Administrimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i paraqet, për miratim, ministrit përgjegjës për ekonominë, vlerën e investimeve të kryera nga qiramarrësi dhe të vlerësuar nga ekspertët përkatës. Me miratimin e vlerës së investimeve, Drejtorja e Administrimit të Pronës Publike bën krahasimin e kësaj vlere dhe të vlerës së truallit, të përcaktuar sipas çmimit të truallit, të konfirmuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dhe të sipërfaqes së truallit të përcaktuar në kontratën e qiramarrjes. Nëse vlera e investimeve të kryera është mbi 150% e vlerës së truallit, ministri nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit.

Për rastet kur ka pronarë toke, vlera e truallit, sipas përcaktimit të bërë në dosjen e privatizimit, i kalon pronarit për kompensim financiar.

IV. DETYRAT DHE TË DREJTAT PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI

1. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe drejtori i ndërmarrjes, përfaqësuesi i organit që ka në pronësi, ruajtje apo varësi administrative objektin, janë të detyruar të përfundojnë dorëzimin, me procesverbal, të objektit, që privatizohet, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e dhënies së autorizimit, nga Ministria e Financave, blerësit.

2. Për diferencat fizike, të lindura ndërmjet periudhës së vlerësimit dhe dorëzimit të objektit ose ndërmarrjes mbahet, në prani të drejtorit të ndërmarrjes një procesverbal, ku evidentohen diferencat fizike dhe arsyet e krijimit. Procesverbali i dorëzimit nënshkruhet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, përfaqësuesi i institucionit, që ka në administrim objektin, dhe fituesi i së drejtës së blerjes së objektit. Ky procesverbal shërben si akt dorëzimi i pasurisë.

3. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, njofton institucionin përkatës administrues për diferencat e rezultuara, sipas procesverbalit të dorëzimit, duke kërkuar nxjerrjen e përgjegjësisë, zhdëmtimin e tyre dhe, kur është e nevojshme, ndjekjen penale.

4. Shitja e truallit është pjesë e kontratës së shitjes së ndërmarrjes ose objektit dhe pagesa e çmimit të truallit bëhet vetëm me lekë.

5. Për rastet kur ka vështirësi në dorëzimin e objektit, me autorizimin e drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, zgjatet afati 45-ditor i dorëzimit. Për rastet kur për blerjen e objektit janë shpallur fitues bashkëpronarë, me të drejtën e parablerjes apo të ankandit, dhe në çastin e nënshkrimit të kontratës njëri nga bashkëpronarët refuzon nënshkrimin e kontratës së shitjes, atëherë zbatohen dispozitat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

6. Procesverbali i nënshkruar dorëzohet në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave i kthen vlerën e munguar blerësit, duke u bazuar në diferencat e përligjura, të evidentuara me procesverbalet përkatëse. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe drejtori i ndërmarrjes, që privatizohet, kanë të drejtë të marrin ekspertë, për dorëzimin e pronës shtetërore, kur ndërmarrja e ka vazhduar veprimtarinë dhe kur vërehen mungesa fizike në njësinë e inventarit. Gjatë procesit të dorëzimit, çdo blerës ka të drejtë të marrë pjesë ose të autorizojë një përfaqësues të tij.

7. Kur blerësi e ka fituar të drejtën e blerjes së pronës shtetërore, nëpërmjet ankandit, dhe kur ka diferenca në dorëzimin e objektit, vlera e kthimit të diferencave është vlera e mungesave fizike, të rezultuara sipas VAM-it, shumëzuar me masën e rritjes së vlerës së ankandit, në krahasim me vlerën fillestare të ankandit, për objektin e shitur. Blerësit i kthehet kjo vlerë me urdhër të Ministrit të Financave.

8. Për kontratat e shitjes, të deklaruara të pavlefshme me vendim gjykatë të formës së prerë, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, ia kthen dosjen e vlerësimit të objektit Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për fillimin e rivlerësimit të objektit, në zbatim të këtij vendimi dhe të legjislacionit në fuqi, për privatizimin.

9. Procedurat e privatizimit të objekteve apo të ndërmarrjeve, të filluara nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe që ndodhen në fazën e pagesës së 80% të vlerës së mbetur të çmimit të objektit apo të çmimit të ankandit, do të përfundohen, sipas procedurave të këtij vendimi.

10. Në zbatim të këtij vendimi, nuk përfshihen procedurat e vlerësimit për dokumentacionin e objekteve, për të cilat dokumentacionet e vlerësimit ndodhen në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe në Ministrinë e Financave, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa për procedurat e shitjes do të zbatohet ky vendim.

11. Ky vendim nuk do të zbatohet për dosjet e vlerësimit, për të cilat DSHP-ja i ka paraqitur kërkesën përkatëse Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa për procedurat e shitjes do të zbatohet ky vendim.

12. Ky vendim nuk do të zbatohet për praktikat, që ndodhen në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, në zbatim të vendimeve të mëparshme, të cilat janë në proces dhe ndodhen në fazën, kur ka përfunduar pagesa për vlerën e plotë të shitjes së tyre.

13. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave të hartojnë udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

14. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, prefekti i qarkut, organet e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

15. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes”, të ndryshuar, dhe nr.78, datë 21.11.1999 “Për ruajtjen e pronësisë shtetërore në disa shoqëri tregtare dhe ndërmarrje”, si dhe udhëzimet e dala në zbatim të tyre, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.37, datë 16.6.2010

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHITESË NGA BANKA CREDINS SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43, shkronjat “c” dhe “e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të nenit 54, pika 2, shkronja “e”, nënpika “i” të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 45 të ligjit nr.9879 datë 21.2.2008 “Për titujt”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Credins sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

“Ndërmjetësimi për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit.”

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të Bankës Credins sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ardian Fullani

KËRKESË

Kërkuesit Engjëll dhe Shpëtim Poda, djemtë e Hasanit dhe Medihasë, të datëlindjes, përkatësisht: 8.9.1945 dhe 10.4.1941, lindur i pari në Korçë dhe i dyti në Leskovik, Kolonjë, banues të dy në Tiranë, kërkojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë shpalljen të vdekur të babait të tyre Hasan Poda.

KËRKUESIT
Engjëll Poda dhe Shpëtim Poda

KËRKESË

Shtetasi Sokol Saliu, i biri i Qemalit dhe i Xixes i datëlindjes 17.9.1968, lindur dhe banues në Durrës, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Artur Saliu.

KËRKUESI
Sokol Saliu

KËRKESË

Shtetësja Iris Ferhati e bija e Mahmutit dhe e Baries, e datëlindjes 8.2.1965, lindur në Sotir Gramsh dhe banuese në fshatin Darëzezë, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj Halit Ferhati.

KËRKUESE
Iris Ferhati

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 7.7.2010

Doli nga shtypi më 8.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë